

THE KOSOVO BANKER

Stimulimi i rritjes së sektorit
privat në Kosovë

Për një integrim të
sekuencuar evropian

Gjendja aktuale e normave
të interesit në Kosovë

Sektori Financiar në Zhvillim të Ekonomisë

Sektori financiar është një ndër sektorët më të qëndrueshëm të ekonomisë në Kosovë dhe përkunër krizave ekonomike në rajon dhe botë, ky sektor ka vazhduar të jetë stabil në vendin tonë. Sektori financiar në Kosovë ka përmirësuar ambientin e të bërit biznes duke financuar shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme të cilat edhe kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik



PROJECT MANAGEMENT
PREPARATORY TRAINING FOR

PMP®


PROJECT MANAGEMENT PROFESSIONALS

If you like the reputation that comes from being the best in your field, then you'll appreciate the professional advantages derived from attaining the PMP status. The PMP designation following your name tells current and potential employers that you have a solid foundation of project management knowledge that can be readily applied in the workplace.


The Project Management Institute (PMI) stands as a global leader in the field of project management. It is well known that PMI certification involves a rigorous, examination-based process that represents the highest quality in professional standards. Therefore, PMI's professional certification is universally accepted and recognized.

TRAINING OFFICIAL MATERIALS:

A Guide to the Project Management
Body of Knowledge: PMBOK Guide



PMP Exam Prep
Sixth Edition by Rita Mulcahy



Advance Your Career with
International Project Management
Certifications
(CAPM® and PMP®
internationally recognized certifications)

Training & Official materials only:
760.00€

Contact Us:

www.aukonline.org/tdi
www.aukonline.org/registertdi
auki@aukonline.org

+381 (0)38 608 608 ext. 600

+377 (0)44 509 801

+386 (0)49 774 112



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 **Banka Ekonomike**

 **BKT**
BANKA KOMBETARE TREGTARE

 **BANKA PËR BIZNES**
BpB
Mundësi për më shumë...

IŞBANK

 **Prishtina**

 **ProCredit Bank**

 **Raiffeisen**
BANK

 **TEB**
BNP PARIBAS JOINT VENTURE



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën

Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencon iniciativat ligjore dhe rregullative; koordinon-bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për Trajtime Bankare, e cila ofron trajtime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. "Bajram Kelmendi", Nr. 15, Prishtinë; 10000, Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

THE KOSOVO BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE

Zt. Robert Wright
Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank Kosovo

Zt. Ilir A. Aliu
Zv. Kryetar i Bordit,
ProCredit Bank

Zt. Atilla Dagdeviren
IS Bank

Zt. Ayhan Albeyoglu
TEB Bank

Zt. Ercan Gurelli
Banka Kombëtare Tregtare

Zt. Ilir Aliu
Banka Ekonomike

Zt. Lavdim Koshutova
NLB Prishtina

Zt. Richard Beasley
Banka për Biznes

DREJTOR EKZEKUTIV

Zt. Petrit Balija

REDAKTORË

Znj. Saranda Spahija Halilaj
Zt. Blond Gerqari

THE KOSOVO BANKER
MBËSHËTETET NGA FONDI EVROPIAN
PËR EVROPËN JUGLINDORE



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY



Give your client the full potential of Internet banking

- Whenever/wherever
- Connecting via favourite device (PC, tablet, mobile, SMS)
- Control of finances with Personal Finance Manager
- Simple orders of new services via internet banking
- Integration with social networking
- Interactivity and attractive design

Optimize your Internet banking services

- Targeted sales of banking services
- Short time to market of new e-banking services
- Paper based operations into paperless activities
- Single Platform for:
 - all e-channels
 - all client types (corporate, SME, individuals)
- Automate your internal work flow
- Support the transparency of cash flow
- Focus on the banking business; use Software as a Service (SaaS)



Halcom d.d., Tržaška cesta 118, 1000 Ljubljana, SLOVENIA/EUROPE

Tel.: + 386 1 200 33 40, Fax: + 386 1 200 33 56,

E-mail: info@halcom.com, www.halcom.com



PËRMBAJTJA

EDITORIAL 1-4

SEKTORI FINANCIAR 5-20

- Menaxhimi i likuiditetit pas Bazel III
- Gjendja aktuale e normave të interesit në Kosovë
- Mbrojtja e konsumatorit të sektorit financiar është prioritet i Bankës Qendrore të Kosovës
- Lizingu, si alternativë financiare
- E ardhmja e bankimit të sotëm elektronik
- Mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit të karrierës në sektorin bankar

KËNDI I EKSPERTËVE 21-24

- Stimulimi i rritjes së sektorit privat në Kosovë
- Për një integrim të sekuencuar evropian

KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 25-27

- Terme financiare që duhet ditur
- 7 këshilla për sigurimin e kartelës suaj debit gjatë një transaksioni në bankomat
- 4 këshilla për mbrojtjen e llogarisë suaj gjatë kryerjes së një transaksioni e-banking

KOMITETET NË SHBK 28

- Komitetet aktive në Shoqatën e Bankave

LAJMET E SHBK-së 29-31

- Robert Wright rizgjedhet Kryetari Bordit të Drejtorëve
- Përfaqësues të shoqatës së bankave të Kosovës vizitojnë shoqatën shqiptare të bankave
- Panairi Financiar 2013
- Punëtorja me studentë, e organizuar në kuadër të Panairit Financiar 2013

- SHBK shpërblen fituesit e lojës shpërblyese nga gazeta 'Kosova Sot'
- Kryetari i Bordit të ShBK-së merr pjesë në konferencën e Fleming Europe
- SHBK merr pjesë në takim rajonal për
- Evropë dhe Azi Qendrore, i organizuar nga Child and Youth Finance International

QENDRA E TRAJNIMEVE 32-33

- Trajnimet e organizuara në shbk

LAJME NGA BANKAT 34-35

- Shitja Online e produkteve dhe e shërbimeve të bizneseve kosovare
- Pagesa e tatimeve, faturave, etj. - me e-Banking nga ProCredit Bank
- Projektet e përkrahura nga Banka Raiffeisen
- Kredi personale deri në 10 000 euro nga BKT


PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE 36-37

- BKT kontribues i shoqërisë
- ProCredit Bank organizon ProKid Lojërat 2013
- ProCredit Bank dorëzon numër rekord të kapakëve të plastikës
- Gara për Videon më të mirë mjedisore
- ProCredit Bank, mbështetësi kryesor i DokuFest-it

KËSHILLA PËR INTERVISTË PUNE 38

- 5 këshilla para një interviste për punë

Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore.



EDITORIAL

**PETRIT BALIJA dr. sc.**

DREJTOR EKZEKUTIV
SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

Të nderuar lexues,

Mirësevini në edicionin e katërt të revistës 'The Kosovo Banker'. Ky edicion është i pasur me tema të aktualitetit ekonomik dhe shtjellon çështje nga më të ndryshmet nga ekonomia, sektori financiar dhe financat personale. Si çdo herë, edhe ky numër i ka dhënë hapësirë të veçantë industrisë bankare duke u ndërlidhur edhe me aspekte tjera të ekonomisë dhe edukimit financiar.

Me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut rreth zhvillimeve të fundit në industrinë bankare dhe në kuadër të iniciativës për edukim financiar të të rinjve dhe publikut të gjerë, Shoqata e Bankave të Kosovës ka arritur që të shpërndajë mbi 10,000 kopje të këtij edicioni me një nga gazetatat ditore në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Ky numër i revistës përmban shkrime nga autorë dhe ekspert të mirënjohur të fushës së ekonomisë dhe legjislacionit të cilët shtjellojnë tema të ndryshme në mënyrë që revista të jetë sa më informuese për publikun dhe të shërbejë si një udhëzues praktik mbi edukimin financiar dhe financat personale. Disa nga temat që shtjellohen në këtë revistë janë: Mundësitë e zhvillimit të sektorit privat në Kosovë, Lizingu në Kosovë, Si ndikojnë trajnimet në zhvillimin profesional të kuadrove;

për më shumë ka shkrime që trajtojnë veçorinë e normave të interesit, dhe shkrime që trajtojnë nismat e reja të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore në lidhje me edukimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit për çfarë edhe Shoqata e Bankave të Kosovës bart një rol të rëndësishëm.

Për më tepër, duke filluar nga numri i kaluar, Shoqata e Bankave të Kosovës në vazhden e edukimit financiar ka inkuadruar udhëzime praktike për klientë të bankave si dhe shkrime informuese rreth fjalëve kyçe që përdoren në përditshmëri në industrinë bankare. Gjithashtu, ky numër përmban shkrime rreth mënyrave se si një klient mund të përdorë bankomatit dhe platformën e-banking duke marrë masa të sigurta që t'a sigurojë kartën e debitit të tij.

Për fund fare, dëshiroj të falënderoj të gjithë autorët që kanë kontribuar në këtë edicion të revistës dhe sponsorëve tanë duke na mundësuar që të kemi një revistë që ofron pikëpamjet e fundit mbi çështjet më të rëndësishme të sektorit financiar, zhvillimit ekonomik dhe edukimit financiar për një të ardhme më të qëndrueshme të vendit.

Ju dëshiroj lexim të këndshëm!




FJALIMI I GUVERNATORIT HAMZA ME RASTIN E HAPJES SË PANAIRIT FINANCIAR 2013

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi të jem sot në mesin tuaj dhe bashkërisht me ju të shohim arritjet e sektorit financiar të Kosovës, gjithashtu shfrytëzoj rastin të përgëzoj Shoqatën e Bankave të Kosovës për organizimin e këtij panairi që tashmë është bërë tradicional. Ky panair tregon më së miri se industria financiare në Kosovë, përkundër faktit që filloi të zhvillohet nga e para vetëm para pak viteve, ka arritur të konsolidohet mirë dhe t'i ofrojë ekonomisë produktet e nevojshme financiare ngjashëm me industrinë financiare të vendeve tjera të cilat për nga «mosha» janë mjaft më të vjetra. Zhvillimi i sektorit financiar të Kosovës që nga fillimi i operimit të tij ka qenë i kënaqshëm si në kontekst të zhvillimit të produkteve, të cilat në vazhdimësi i janë përgjigjur nevojave në rritje të ekonomisë, ashtu edhe në kontekst të qëndrueshmërisë duke bërë që ky sektor njëkohësisht t'i kontribuojë rritjes së aktivitetit ekonomik dhe ruajtjes së stabilitetit makroekonomik në vend.

Sistemi bankar, si përbërësi kryesor i sek-

torit financiar në Kosovë, ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin dhe në të njëjtën kohë të ruajë qëndrueshmërinë në një nivel të lartë. Rëndësia e stabilitetit të sistemit bankar është vënë në dukje posaçërisht në vitet e fundit kur ekonomia globale u ballafaqua me një ndër krizat më të rënda ekonomike e në të cilën paqëndrueshmëria e sektorëve bankar jo vetëm që shkaktoi ndërprerjen e financimit për ekonominë por bëri që sistemet bankare të bëhen barrë e rëndë për financat publike. Në Kosovë, fatmirësisht, patëm një situatë tjetër ku bazat e shëndosha mbi të cilat ishte ndërtuar sistemi bankar bënë që edhe në kohën kur burimet e financimit nga jashtë ishin dobësuar, kreditimi bankar së bashku me zgjerimin e shpenzimeve publike të kishin rol të rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik në vend, duke zbutur kështu ndikimin e efekteve të krizës në ekonominë e Kosovës. Kjo kontribuoi që ekonomia e Kosovës gjatë gjithë kësaj periudhe të vazhdojë të rritet madje me normën më të lartë të rritjes në rajon, gjë e cila në mënyrë të



ndërsjellë i kontribuoi edhe vetë stabilitetin të sistemit bankar.

Gjate vitit 2013, aktiviteti kredithënës i sistemit bankar të Kosovës ka vazhduar të rritet përderisa burimi kryesor i financimit të kësaj rritje vazhduan të jenë depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, duke bërë kështu që niveli i ekspozimit të sistemit bankar ndaj lëvizjeve në tregjet globale të vazhdojë të jetë i ulët. Treguesit e shëndetit të sistemit bankar vazhdojnë të reflektojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë. Cilësia e portofolit kreditor, përkundër rritjes së lehtë të kredive joperformuese në periudhën e fundit, vazhdon të jetë e mirë me normë një shifrore të pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej kreditë. Për më tepër, niveli i lartë i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizionet për humbje nga kreditë si dhe niveli i lartë i kapitalizimit e bëjnë sistemin bankar të Kosovës të qëndrueshëm kundrejt rrezikut kreditor, gjë e cila konfirmohet edhe nga analizat e tjera të ndjeshmërisë së sistemit bankar që bën Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Niveli i lartë i likuiditetit që mirëmban bankat të cilat operojnë në Kosovë ka bërë që në asnjë moment të mos vihet në pikëpyetje aftësia e bankave për të përmbushur detyrimet e tyre. Për këtë, bankat padyshim që janë shpërblyer përmes rritjes së besimit të publikut që është shprehur përmes stabilitetit dhe rritjes së vazhdueshme të depozitave në sistemin bankar. Si do që të jetë, përkundër rolit shumë të rëndësishëm që sistemi bankar ka luajtur për ekonominë e Kosovës, ka ende mjaft

hapësirë që ky rol të avancojë edhe më tutje në mënyre që ndikimi i tij për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe për zhvillimin e mëtejshëm të vetë sistemit bankar të jetë edhe më i madh. Kur them avancimin e rolit të sistemit bankar kam parasysh avancimin në tre drejtime kryesore:

1. Kohët e fundit, përkundër rritjes, vërejmë që kreditimi i sektorit bankar në Kosovë ka shënuar ngadalësim të trendit të rritjes. Kjo po ndodh në një kohë kur bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe kanë nivel të kënaqshëm të likuiditetit, ndërsa rreziqet në ekonominë e vendit mund të konstatohet se po zvogëlohen marrë parasysh se këtë vit rritja ekonomike në Kosovë parashihet të jetë edhe më e lartë se sa në vitin paraparak. Andaj, ne inkurajojmë bankat që operojnë në Kosovë të rishikojnë vlerësimet e tyre rreth rrezikut në ekonominë e Kosovës dhe strategjitë e tyre investive të përshtatin sa më tepër me rrethanat në ekonominë e Kosovës dhe në këtë mënyrë të evitojnë sjelljen e masave të dizajnuara për bankat që operojnë në vende të tjera dhe të cilat ballafaqohen me profil tjetër të rrezikut (kjo vlen veçanërisht për bankat e huaja që operojnë në Kosovë).

2. Përveç nevojës për rritje të kreditimit, nevojitet që bankat të ndër marrin një rol më proaktiv për rritjen e kreditimit drejtë sektorëve më pak të kredituar në ekonominë e Kosovës siç është sektori i bujqësisë. Në këtë mënyrë, roli i bankave në zhvillimin ekonomik të vendit ku operojnë bëhet më i rëndësishëm, por në të njëjtën kohë



krijohen kushtet për zgjerimin e mundësive investive për vetë bankat. Rritja e kreditimit të këtyre sektorëve pa dyshim që kërkon një angazhim edhe më të madh të autoriteteve shtetërore në mënyrë që këta sektorë të jenë në gjendje ti plotësojnë në masën më të madhe kriteret e bankave për kreditim.

3. Përkundër rënies që kanë shënuar normat e interesit në kredi, në periudhat e fundit, mund të vlerësohet se ka nevojë për rritje të mëtejme të efikasitetit në sistemin bankar në mënyrë që kostoja e financimit të zvogëlohet edhe më tutje. Krijimi i kushteve për rritje të efikasitetit të sistemit bankar paraqet një prioritet të rëndësishëm të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës e cila në vazhdimësi është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për rritjen e efikasitetit të sistemit bankar. Në këtë kontekst, vlen të theksohet licencimi i bankave të reja dhe kontributi i tyre në rritjen e konkurrencës; avancimi i vazhdueshëm i sistemit të pagesave; avancimi i regjistrimit të kredive ... dhe ajo që është mjaft me rëndësi është angazhimi që po bëjmë për të siguruar një adresim më efikas të rasteve bankare në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Për adresimin e çështjeve që i ngrita më lart natyrisht që, përveç Bankës Qendrore dhe bankave komerciale, kërkohet një angazhim më gjithëpërfshirës i të gjithë akterëve në ekonominë e vendit, përfshirë audiencën e gjerë që po ndjekë këtë panair, në mënyrë që të ballafaqojmë pikëpamjet dhe të gjejmë mënyrën më të mirë se si sistemi bankar

dhe sektori financiar në përgjithësi të vazhdojë të zhvillohet edhe më tutje dhe në këtë mënyrë kontributi i këtij sektori të jetë edhe më i madh për zhvillimin ekonomik të vendit. Andaj, panairi i sotëm, përveç që ofron një mundësi të mirë që të njihemi më për se afërmi me të arriturat e sektorit financiar, ofron edhe një mundësi tjetër tejet të rëndësishme - atë të ballafaqimit të ideve dhe pikëpamjeve të ekspertëve rreth segmenteve të ndryshme të aktivitetit të sektorit financiar në vend.

Në fund, edhe një herë përgëzoj Shoqatën e Bankave të Kosovës për organizimin e këtij panairi dhe uroj që raste të tilla ku kemi mundësinë të shohim ngjarje të suksesshme të kemi sa më shpesh.

“Me riskun e tregut mund të humbësh pasurinë, me riskun e likuiditetit mund të humbasësh bankën!”

Chris O’Neill, Bruce Forrest

Menaxhimi i likuiditetit pas Bazel III

Për t’u siguruar që bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm për të mbijetuar tronditjet eventuale likuide që ndodhen disa vjet më parë, Komiteti Bazel për herë të parë në historinë bankare ka lëshuar dy standarde të reja minimale globale të reviduara në kuadër të rregullave Bazel III – LCR – Liquidity Coverage ratio (Koeficienti i mbulimit likuid) dhe NSFR – Net Stable Funding Ratio (Neto Koeficienti i financimit stabil).

Sivjet, në kohën kur bankat në Kosovë brengoseshin për zbatimin e rregullave të reja bankare lokale, bankat ndërkombëtare morën dhuratën e papritur nga rregullatorët ndërkombëtarë – standarde minimale globale për menaxhimin e likuiditetit.

Pas krizës së vitit 2008 dhe kolapsit të disa bankave, trupa rregullatore 27-anëtarëshe me seli në Zvicër – Komiteti Bazel kërkonte mënyrën për të shtrënguar kontrollin mbi kapitalin dhe likuiditetin e bankave.

Likuiditeti është aftësia për të shlyer detyrimet aktuale të bankës. Rreziku i likuiditetit është rreziku që banka nuk do të mund të financojë rritjen e investimeve apo t’i mbulojë detyrimet aktuale. Për të menaxhuar këtë, banka nevojitet të mbajë një pjesë të mjeteve të veta të paangazhuara në formë shumë likuide.

Zakonisht bankat brengosen për likuiditetin e tyre në dy situata.

1. Në rrethana normale të biznesit dhe
2. Në rrethana të jashtëzakonshme (situata të stresit).

Në rrethana normale të biznesit bankat kanë metodat zhvilluara të suksesshme për menaxhimin e likuiditetit, por kriza e fundit financiare dëshmoi që bankat nuk kanë qenë të përgatitura të përballen me deficitin e mjeteve likuide në një situatë të jashtëzakonshme të stresit.

**BORYANA IVANOVA
MUSTAFA**

DREJTORE
E DIVIZIONIT
TË PAGESAVE
DHE THESARIT
NLB PRISHTINA



Për t’u siguruar që bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm për të mbijetuar tronditjet eventuale likuide që ndodhen disa vjet më parë, Komiteti Bazel për herë të parë në historinë bankare ka lëshuar dy standarde të reja minimale globale të reviduara në kuadër të rregullave Bazel III – LCR – Liquidity Coverage ratio (Koeficienti i mbulimit likuid) dhe NSFR – Net Stable Funding Ratio (Neto Koeficienti i financimit stabil).

Rregullat Bazel III (fillimisht të lëshuara më 2010) paraqesin një paketë reformash që vjen pas disa rregullave të draftuara më herët, si dhe përfshijnë si kërkesa të reja për kapital të bankave, ashtu edhe rregulla të standardizuara në fushën e likuiditetit.

LCR – Liquidity Coverage Ratio (Koeficienti i mbulimit likuid)

LCR synon të sigurojë që bankat kanë mjaft mjete likuide të paangazhuara të kualitetit të lartë për të absorbuar rreziqet e skenarëve të ndryshëm të stresit që mund të zgjasin deri në një muaj, d.m.th. të mbulojnë të gjitha daljet neto rrjedhëse të parasë në një situatë të jashtëzakonshme.

Në kuptim më të gjerë, standardi LCR synon të rrisë fleksibilitetin e profilit afatshkurtër të rrezikut të likuiditetit të bankave, në mënyrë që bankat të vetësigurohen që kanë mjetet e mjaftueshme të cilësisë së lartë likuide për të përballuar një tronditje të likuiditetit që zgjat deri në një muaj.

Koeficienti LCR ka dy komponente:

(a) vlera e rezervës së MLKL-së (Mjete likuide të kualitetit të lartë) në rrethana të stresit;

(b) gjithsej neto daljet rrjedhëse të parasë dhe shprehet nëpërmes formulës:

Mjete likuide të kualitetit të lartë (MLKL)

≥ 100%

Gjithsej neto daljet rrjedhëse të parasë për 30 ditët e ardhshme

Mjete likuide të kualitetit të lartë konsiderohen të gjitha mjetet që shpejt mund të shndërrohen në para, posaçërisht në situatë të jashtëzakonshme. Mjetet që kualifikohen si mjete likuide të cilësisë së lartë, sipas Bazel III ndahen në dy kategori:

- A. Mjetet Nivelit 1 dhe
- B. Mjetet Nivelit 2.

Si mjetet likuide, ashtu edhe zërat e tjerë të raportit peshohen me % të disponueshmërisë dhe reduktohen në bazë të faktorit peshues. Pasi që mjetet e Nivelit 1 janë të kualitetit shumë të lartë, tek ato nuk aplikohet reduktim në disponueshmërinë e tyre dhe vlera e tyre peshohet me 100%.

Ndërsa për mjetet e Nivelit të dytë aplikohet reduktim 15% në disponueshmërinë e fondeve të këtij grupi dhe mjetet e Nivelit 2 peshohen me 85%.

MLKL	Faktori peshues
<p>Mjetet e Nivelit 1 janë:</p> <p>Paratë e gatshme, letrat me vlerë të tregtueshme të lëshuara nga shteti, bankat qendrore, ndërmarrjet e sektorit publik (NSP) ose bankat ndërkombëtare zhvillimore, rezervat e kualifikueshme në bankat qendrore, borxhi vendës sovran ose të Bankës Qendrore në monedhë vendëse, borxhi vendës sovran i shteteve të peshuara me rrezik mbi 0%, lëshuar në monedhë të vendit.</p>	100%
<p>Mjetet e Nivelit 2 janë:</p> <p>Investime shtetërore në bankat qendrore, ndërmarrjet e sektorit publik (NSP) që kualifikohen me peshë të rrezikut 20%, bonde të kualifikueshme të korporatave të ranguar me AA- ose më lart, bonde të kualifikueshme të mbuluara të ranguar me AA- ose më lart.</p>	85%

Për të gjetur **Neto daljet rrjedhëse të parasë për 30 ditët e ardhshme** duhet shumëzuar bilancet aktive të detyrimeve të bankës dhe pozicionet jashtëbilancore me normat në të cilat ato priten të dalin apo të tërhiqen.

Neto daljet rrjedhëse të parasë për 30 ditët e ardhshme = Daljet – Minimumi i {Hyrjeve ose Vlera prej 75% të Daljeve}.

Edhe nëse banka ka rrjedha hyrëse më të mëdha se daljet e pritura, aplikohet tavan i prej 75% të hyrjeve, në mënyrë që të evitohet që bankat të mbështeten vetëm në rrjedhat hyrëse për të përmbushur standardin minimal të likuiditetit, por vërtet të ndërtojnë rezerva kualitative të mjeteve likuide.

Daljet rrjedhëse të parave të gatshme përfshijnë depozitat avista dhe depozitat e afatizuara të kualifikueshme me maturitet të mbetur deri më 30 ditë. Këto detyrime të bankës peshohen me faktorë nga 5% deri në 100%, varësisht prej disa karakteristikave të tyre: nëse janë të siguruara nga ndonjë skemë e sigurimit të depozitave, nëse janë stabile apo më pak stabile, nëse janë të klientëve individualë apo të personave juridikë.



Hyrjet rrjedhëse të parave të gatshme përfshijnë të gjithë kërkesat e bankës që priten të arkëtohen brenda horizontit 30-ditësh, duke i peshuar me faktorë të realizimit nga 0% deri në 100%, varësisht nga disa karakteristika të tyre: nëse janë të arkëtueshme nga klientët individualë, bizneset, institucionet e tjera financiare, etj.

LCR duhet zbatuar për çdo valutë. Përdorimi i valutës EUR në Kosovë si valutë (monedhë) e vendit (eurizimi) optimizon menaxhimin e likuiditetit të bankave dhe ndihmon për eficientë e likuiditetit, pasi që shumica e kërkesave dhe detyrimeve të bankave janë në këtë valutë, si dhe shndërrimi i mjeteve në para dhe bartja e tyre për mbulimin e detyrimeve përkatëse bëhet mjaft shpejt si në tregun e vendit ndërbankar, ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare, pa i ekspozuar bankat në rrezikun e këmbimit valutor.

NSFR - Net Stable Funding Ratio (Neto koeficienti i financimit stabil)

Neto Koeficienti i financimit stabil (NSFR) ka një horizont kohor prej një viti dhe është i zhvilluar për të siguruar qëndrueshmërinë e bankës në perspektivë afatgjate të maturimit të mjeteve dhe detyrimeve të bankës. NSFR themelon minimum nivelin e shumës së pranuar të fondeve stabile të financimit dhe është strukturuar që të sigurojë që mjetet afatgjate të jenë të financuara nga burime stabile në relacion me profilin e tyre të rrezikut.

Koeficienti NSFR i ka dy komponente:

- (a) Shuma e disponueshme e burimeve stabile të financimit (ASF); dhe
- (b) Shuma e kërkuar e burimeve stabile të financimit (RSF).

Dhe shprehet nëpërmes formulës:

Shuma e disponueshme e burimeve stabile të financimit (ASF)

> 100%

Shuma e kërkuar e burimeve stabile të financimit (RSF)

Shuma e disponueshme e burimeve stabile të financimit (ASF) përfshin:

- a) kapitalin – duke përfshirë kapitalin e klasit të Parë dhe Dytë (Tier I dhe Tier II), siç është definuar në standardet globale të kapitalit;
- (b) aksionet preferenciale (të papërfshira në Tier II) me maturim të barabartë apo më të gjatë se një vit,
- (c) detyrimet me maturitet efektiv prej një viti apo më shumë,
- d) pjesa “stabile” e depozitave të paafatizuara ose depozitat e afatizuara të personave fizikë apo bizneseve të vogla me maturitet deri në një vit, por që priten të qëndrojnë në bankë për një periudhë më të gjatë në rast të rrethanave të stresit idiosinkratik,
- (e) pjesa “më pak stabile” e depozitave të paafatizuara ose depozitat e afatizuara me maturitet deri në një vit, por që priten të qëndrojnë në bankë për një periudhë më të gjatë në rast të rrethanave të stresit idiosinkratik,
- (g) Të gjitha kategoritë e tjera të detyrimeve dhe kapitalit që nuk janë të përfshira më lart.

Të gjitha kategoritë maten me faktorë peshues nga 100%, duke zbritur deri në 0% varësisht nga stabiliteti i burimeve të fondeve.

Shuma e kërkuar e burimeve stabile të financimit (RSF) përfshin të gjitha investimet me maturitet deri në një vit që kërkojnë burime stabile të financimit, siç janë: instrumentet financiare të borxhit dhe kapitale, kredi ndaj institucioneve jofinanciare, kredi ndaj personave juridikë, kredi ndaj personave fizikë, mjetet e tjera që nuk janë kategorizuar në mënyrë specifike, zërat jashtëbilancorë. Të gjithë zërat që kërkojnë financim stabil e masin nevojën e financimit nëpërmes faktorëve peshues, varësisht nga niveli i nevojës për financim stabil.



Për shembull, investimet në letra me vlerë afatshkurtra kanë 0% RSF faktor, pasi që janë mjaft likuide nuk kanë nevojë të mbështeten nga burime stabile të financimit, ndërsa kreditë ndaj personave fizikë dhe bizneset e vogla me maturim deri në një vit kanë 85% RSF faktor, pasi që janë më pak likuide dhe kërkojnë mbështetje më të madhe stabile të financimit.

Rregullat Bazel III nuk kanë fuqi juridike. Prandaj, në Bashkimin Evropian këto rregulla marrin formën e nevojshme juridike zbatuese përmes EU Rregullorës No 575/2013.. Paketa rregullative do të hyjë në fuqi më 1 janar 2014, por disa dispozita do të implementohen gradualisht mes 2014-2019 dhe do të hyjnë plotësisht në fuqi në formën siç janë paraparë më 1 janar 2019.

Fazat e implementimit të standardeve	2015	2016	2017	2018	2019
LCR	60%	70%	80%	90%	100%
NSFR	Periudhë vezhguese		hyn në fuqi		

Implementimi eventual i rregullave Bazel III në Kosovë varet nga rregullatori vendës. Situata momentale e hiperlikuiditetit të bankave tregon që bankat në Kosovë i plotësojnë standardet minimale globale të likuiditetit.

Prioritet për të ardhmen për sektorin bankar do të ishte që Rregullatori vendës të krijojë rregulla të thjeshta për bankat për qasje në likuiditet shtesë dhe të gjejë instrumentin e përballueshëm për bankat në rast se likuiditeti i bankave në Kosovë avullohet.

Rregullat Bazel III sugjerojnë që rregullatorët apo bankat të mos kufizohen vetëm deri në nivelin minimal të paraparë, por duke marrë parasysh që disa nga kërkesat e rregullave Bazel III zbatohen për instrumente financiare, të cilat as nuk ekzistojnë në Kosovë, është më se e nevojshme të gjendet bilanci korrekt mes rregullatës vendëse dhe rregullave ndërkombëtare.

Shtrengimi i kontrollit mbi likuiditetin e bankave ka për qëllim të sigurohet një bazë stabile likuide, që është kusht mjaft i rëndësishëm për stabilitetin e sektorit bankar, respektivisht për evitimin e impaktit negativ në sektorin real. Mirëpo, sa duhet të paguajnë bankat për zbatimin e këtyre rregullave dhe sa prej aktiviteteve të tyre kreditore më profitabile do të pësojnë pritjet të shihet në katër vjetët e ardhshëm.

Burime:

Basel Committee Rules

Basel III: International framework for liquidity risk measurement, standards and monitoring

Në qoftë se i ke borxh bankës 100 dollarë, ai është problem yti. Në qoftë se i ke borxh bankës 100 milionë dollarë, ai është problem i bankës.

(J.Getty)

Gjendja aktuale e normave të interesit në Kosovë

Pjesa e parë

Që nga periudha e pasluftës e deri më sot norma e lartë e interesit në kredi mbetet një ndër çështjet më të diskutuara në Kosovë, jo vetëm nga huamarrësit, por edhe nga analistët ekonomik në përgjithësi. Sipas Bankës Botërore (2012), norma mesatare e interesit në kredi më e lartë në rajon është në Serbi me 17.4%, duke pasuar Kosova me 12.9%, Shqipëria me 10.9%, Mali i Zi me 9.6%, Maqedonia me 8.5% dhe Bosnjë e Hercegovina me 6.9%. Po qe se e marrim parasysh normën reale të interesit (duke përshtatur inflacionin), Kosova prapë prin me normën më të lartë të interesit, kësaj radhe duke kaluar nga vendi i dytë në vendin e parë. Megjithatë, nëpërmes këtij artikulli unë do mundohem t'i shtjelloj kundërgargumentet e kritikave të zakonshme, duke shpjeguar arsyen pse jemi në një gjendje të tillë dhe se gishti nuk duhet drejtuar bankave, por Qeverisë së Kosovës që vazhdon të ofrojë një gjendje të brishtë ekonomike, juridike dhe sociale në vend. Ndërsa, në pjesën e dytë të artikullit në buletin e ardhshëm do të argumentoj se në gjendjen aktuale, deri në sa për qind bankat kanë hapësirë t'i ulin normat e tyre të interesit në kredi.

Kthimet e larta në kapital - Shumë analistë me të drejtë argumentojnë se kthimi i kapitalit nga bankat në Kosovë është më i larti në rajon (edhe pse në rënie e sipër). Sidoqoftë, argumenti kritik nuk duhet të fillojë dhe të mbarojë këtu. Rregullat bazike ekonomike shpjegojnë se investimet me rrezik më të ulët shpesh shoqërohen me kthime apo humbje më të vogla investimesh, përderisa investimet me rrezik më të lartë shpesh shoqërohen me kthime potenciale apo humbje investimesh më të mëdha. Në këtë kontekst, kthimi më i lartë i kapitalit nuk duhet shikuar si diçka absurde, por si parim bazik ekonomik. Kjo për shkak se, sipas raportit të Bankës Botërore "Lehtësitë për të bërë biznes" (2012), Kosova renditet në vendin e 157-të në botë, nga 183 gjithsej sa i përket zbatimit të kontratave,



EDON XHARRA

ANALIST I RISKUT
PËR KORPORATA

RAIFFEISEN
BANK KOSOVA

më poshtë se Gaboni, Etiopia, e madje edhe se Iraku që është në gjendje konflikti, përderisa vendet fqinje, si Shqipëria dhe Maqedonia, renditen në vendin e 85-të, respektivisht 60. Sipas UNDP-së (2013), gjykatat perceptohen si një ndër institucionet më të korruptuara në Kosovë. Kjo do të thotë se në Kosovë është shumë më vështirë të ekzekutohen lëndët në gjykatë në rast të dështimit të kredisë në krahasim me vendet e tjera, duke rritur rrezikun në vend dhe si rezultat, duke rritur nivelin e kërkimit të kthimit në kapital.

Kreditë joperformuese (KJP) - Shumë kritikë me të drejtë argumentojnë se KJP në Kosovë janë më të ulëta në rajon, ku sipas Bankës Botërore dhe Bankave Lokale Qendrore në vitin 2012, Kosova shënon 6.4%, pastaj Maqedonia 9.7%, Bosnja 12.6%, Mali i Zi 17.6%, Serbia 19.5%, dhe Shqipëria 21.1%. Sidoqoftë, argumenti se ky faktor duhet të shërbejë si instrument për uljen e normës së interesit është i gabuar, për shkak të gjyqësorit shumë të dobët në Kosovë. Me këtë gjyqësor Kosova nuk është në pozitë më të lakmuar me nivel më të ulët të KJP-ve, për shkak se më mirë do të ishte një normë më e lartë e KJP-ve, të cilat do të mund të ekzekutoheshin nga gjyqësori më lehtë, sesa një KJP më e ulët, por pothuajse e pashpresë në likuidimin

Në ekonomi termi “ekonomia e shkallës” përdoret për të shpjeguar se kur sasia e prodhimit rritet, kosto mesatare për njësi ulet dhe si rezultat mundësohet rënia e çmimit shitës. Sa më i madh tregu, aq më e madhe mundësia për t'i ulur kostot mesatare për njësi. Pikërisht këtu çalon Kosova, ku tregu këtu është shumë më i vogël se në vendet në rajon, me gjithsej vlerë të kredive në treg prej 1.77 miliardë euro.

e tyre. Këtë e konfirmon edhe Banka Qendrore e Kosovës (2012), duke i konsideruar si të humbura rreth 60% të KJP-ve në Kosovë, tre fish më shumë sesa në Shqipëri, ku vetëm 19.9% të KJP-ve konsiderohen si të humbura.

SPREAD-i i madh - Kritikët me të drejtë argumentojnë se SPREAD-i në Kosovë (i njohur si fitimi bruto i bankave, apo konkretisht dallimi mes normave të interesit në depozita dhe normave të interesit në kredi) është më i larti në rajon. Sipas Bankës Botërore (2012), Kosova prin me 9.1%, duke pasuar Serbia me 6.8%, Mali i Zi me 6.3%, Shqipëria me 5.5%, e kështu me radhë. Sidoqoftë, argumentimi se ky faktor duhet të shërbejë si instrument për uljen e normës së interesit është i gabuar, pasi që anashkalon një faktor shumë të rëndësishëm, madhësinë e tregut dhe rolin e ekonomisë së shkallës. Në ekonomi termi “ekonomia e shkallës” përdoret për të shpjeguar se kur sasia e prodhimit rritet, kosto mesatare për njësi ulet dhe si rezultat mundësohet rënia e çmimit shitës. Sa më i madh tregu, aq më e madhe mundësia për t'i ulur kostot mesatare për njësi. Pikërisht këtu çalon Kosova, ku tregu këtu është shumë më i vogël se në vendet në rajon, me gjithsej vlerë të kredive në treg prej 1.77 miliardë euro, përderisa në Maqedoni dhe në Shqipëri është dyfish më shumë, me 3.46 miliardë, respektivisht 3.9 miliardë euro, ndërsa në Serbi dhjetëfish më shumë, me 17.5 miliardë euro (Bankat përkatëse Qendrore, 2012). Si rezultat, tregjet më të mëdha mund të operojnë me SPREAD më të ulët dhe në të njëjtën kohë të fitojnë edhe më shumë se në Kosovë, ku SPREAD-i është më i lartë, pasi që tregu është më i vogël.

Konkurrenca e vogël dhe kërkesa më e lartë se oferta - Edhe pse në Kosovë operojnë tetë banka të ndryshme, sipas BQK-së (2012), vetëm tri banka të huaja menaxhojnë 72% të gjithsej asetëve të sistemit bankar, duke krijuar një treg

oligopolist në vend. Sidoqoftë, duhet kuptuar që as oligopoli, madje as monopoli nuk është ilegal, por keqpërdorim i pozitës oligopoliste apo monopoliste është ilegal. Gjithashtu, rregullat bazike ekonomike shpjegojnë se kur kërkesa tejkalon ofertën, çmimi rritet, dhe anasjelltas.

Kualiteti i dobët i raportimit financiar të kredimarrësve dhe strukturat menaxhuese joprofesionale - Sipas Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe kompanisë konsulente “Baker Tilly Kosovo” (2012), nga mijëra ndërmarrje të regjistruara në vend, vetëm 150 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat e audituara financiare. Gjithashtu, sipas raportit “Qasja në Financa 2012” nga Bashkimi Evropian, një pjesë e konsiderueshme e strukturave menaxhuese të kompanive në Kosovë përbëhen prej pronarëve apo familjarëve të tyre dhe jo nga menaxherë kompetentë dhe profesionalë.

Për fund, qëllimi i këtij artikulli ishte për të shpjeguar arsyet pse i kemi normat e larta të interesit në kredi, dhe jo për t'i mohuar normat e larta të tyre. Përkundrazi, normat aktuale shumë vështirë përballohen nga shumica e individëve dhe bizneseve në Kosovë. Përderisa në artikullin e ardhshëm do argumentoj saktësisht se sa e vogël është hapësira e bankave për uljen e normës së interesit në kredi në gjendjen aktuale dhe sa është përqindja minimale ku bankat do operonin pa profit, dua të theksoj se kritikën nuk duhet drejtuar vetëm bankave, të cilat kryesisht janë investime të huaja në Kosovë, por Qeverisë së Kosovës për mospërmirësimin e gjendjes së rëndë ekonomike, juridike dhe sociale në vend.

Nr.	Argumentet e kritikëve	Argumentet e kundërta
1	SPREAD-i i lartë	Ekonomia e ulët e shkallës (tregu i vogël)
2	KJP-të e ulëta	Gjyqësori i dobët dhe korrupcioni i lartë. Më mirë KJP më të larta por që ka shpresë për tu përmirësuar dhe kthyer, se sa KJP të ulëta por shumica të humbura
3	Kthimet e larta	Rreziku i lartë (skcionerët kërkojnë kthime më të larta kur rreziku i kapitalit të tyre është më i lartë)
4		Kualiteti i dobët i raportimit
5		Evazioni i lartë fiskal
6		Gjendja e rëndë ekonomike (GDP dhe GDP per capita më të ulëta në rajon, papunësia dhe deficitit tregtar më i larti në rajon)
7		Kërkesa e lartë, oferta jo në potencialin e saj për shkak të rrezikut
8		Strukturat menaxheriale jo profesionale (familjarë)
9		Konkurrenca e vogël (treg oligopol, vetëm 3 banka posedojnë 72% të tregut)

	Norma reale e interesit në kredi	Norma e interesit në kredi	Norma e interesit në depozita	SPREAD-i	KJP-të	Kthimi në kapital	Vlera e kredive të lëshuara në treg (në miliarda Eura)
Kosova	11.7%	12.9%	3.7%	9.1%	6.4%	12.9%	1.77
Maqedonia	8.0%	8.5%	5.1%	3.4%	9.7%	3.3%	3.46
Shqipëria	7.7%	10.9%	5.4%	5.5%	21.1%	11.4%	3.9
Mali i Zi	7.1%	9.6%	3.3%	6.3%	17.6%	-3.0%	1.86
Serbia	11.2%	17.4%	10.6%	6.8%	19.5%	4.9%	17.5
Bosnja	5.0%	6.9%	2.9%	3.9%	12.6%	7.7%	8.15
Burimi/Viti	BB (2012)	BB (2012)	BB (2012)	BB (2012)	BB (2012)	BB (2011)	Banka qendrore lokale (2012)

Vërejtje: "BB" qëndron për Bankën Botërore. Vlerat e hijëzuara kanë burimin nga bankat lokale qendrore, për shkak të mungesës së të dhënave nga BB për atë vit. Norma reale e interesit në kredi duke u përfshatur për inflacion.

Pjesa e dytë e artikullit do të publikohet në numrin e ardhshëm të revistës.

Mbrojtja e konsumatorit të sektorit financiar është prioritet i Bankës Qendrore të Kosovës

Këtë vit BQK-ja ka lansuar Strategjinë e saj për Mbrojtjen e Konsumatorëve që do të fokusohet në ofrimin e ndihmës për përdoruesit e shërbimeve financiare që të marrin vendime të informuara dhe të mbrojnë të drejtat e tyre. Strategjia u zhvillua pas një rishikimi të thellë diagnostik të praktikave të mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin financiar në Kosovë.

Shërbimet e sektorit financiar prekin jetën e secilit prej qytetarëve të Kosovës. Mundësojnë rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, ndërtimin e infrastrukturës thelbësore dhe zhvillimin e qëndrueshëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. Prandaj, Banka Qendrore e Kosovës (BQK), në bashkëpunim me institucionet relevante është shumë e angazhuar në ndërtimin e tregut financiar që trajton konsumatorët me drejtësi, inkurajon përfshirje financiare dhe ndihmon njerëzit në përdorimin efektiv të shërbimeve financiare. Ndërtimi i një tregu të sigurt dhe të drejtë financiar është një punë afatgjate që kërkon një angazhim dhe mbikëqyrje të vazhduar të institucioneve financiare dhe të agjencive të tjera qeveritare.

Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve rregullon mbrojtjen themelore të të drejtave të konsumatorëve gjatë blerjes së produkteve dhe shërbimeve, si dhe formave të tjera të pranimit të produkteve dhe shërbimeve në treg. Ofruesit e produkteve dhe shërbimeve janë përgjegjës për të vendosur produkte dhe shërbime të sigurt në treg. Ngjashmërisht, produkte dhe shërbime

SHKËNDIJE HIMAJ

KËSHILLTARE
E LARTË E BORDIT
EKZEKUTIV

SEKTORI
FINANCIAR DHE AT
BANKA QENDRORE
E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS



të sigurt konsiderohen produktet dhe shërbimet që plotësojnë:

- Standardet lokale,
- Standardet evropiane të përkufizuara nga marrëveshjet ndërkombëtare,
- Kërkesat legjitime të konsumatorëve në lidhje me sigurinë.

Vetë ligji nuk është i mjaftueshëm për të siguruar që të drejtat janë duke u mbrojtur në mënyrë të duhur. Është e domosdoshme që konsumatorët të veprojnë mbi të drejtat dhe obligimet e tyre në përputhje me ligjin. Veprimet e konsumatorëve mund të jenë efektive vetëm nëse janë plotësisht të pajisura dhe kuptojnë informatat e duhura për të ushtruar të drejtat. Prandaj, edukimi financiar është i rëndësishëm kritikë në rastin e marrjes së vendimeve të informuara.

Produktet dhe shërbimet financiare janë mjaft komplekse në kualitetet e tyre, prandaj zhvillimi i sigurt dhe i drejtë i mjedisit për dispozitat e shërbimeve financiare është një ndër qëllimet kyçe strategjike të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Këtë vit BQK-ja ka lansuar Strategjinë e saj për Mbrojtjen e Konsumatorëve që do të fokusohet në ofrimin e ndihmës për përdoruesit e shërbimeve financiare që të mar-

rin vendime të informuara dhe të mbrojnë të drejtat e tyre. Strategjia u zhvillua pas një rishikimi të thellë diagnostik të praktikave të mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin financiar në Kosovë. Rishikimi u drejtua me mbështetjen nga ekspertët e Bankës Botërore. Rishikimi diagnostik i mbrojtjes së konsumatorëve dhe dijes financiare në Kosovë është pjesë e diagnostikimeve serike të Bankës Botërore, të udhëhequr në më shumë se 20 shtete në Evropë dhe më tej. Pak pasi strategjia u zhvillua, BQK u angazhua në një Memorandum të Mirëkuptimit me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë me qëllim të bashkëpunimit për përdorimin e përbashkët të informatave dhe trajtimin efektiv të ankesave në lidhje me institucionet e ndërlidhura. Për të fuqizuar më tej efektivitetin e bashkëpunimit, BQK-ja ka emëruar një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit për Këshillin e Mbrojtjes së Konsumatorëve. Gjithashtu, strategjia e zhvilluar nga BQK-ja plotëson Programin e Mbrojtjes së Konsumatorëve në Kosovë, më specifikisht të konsumatorëve të institucioneve financiare. Strategjia e BQK-së për Mbrojtjen e Konsumatorëve u zhvillua në mënyrë që të listojë objektivat dhe veprimet që shtrihen prej atyre që mund të zbatohen brenda disa muajve, deri te ato që mund të zbatohen brenda disa vjetëve.

Në afat të shkurtër, BQK do të fokusohet në tri fusha. Ka filluar me të kuptuarit e përmirësuar se si institucionet financiare trajtojnë klientët e tyre, duke analizuar të dhënat për sektorin financiar dhe duke u fokusuar në institucionet që paraqesin risk më të lartë ndaj klientëve. Është duke mbikëqyrur aktivisht sjelljet e institucioneve financiare dhe duke u siguruar që konsumatorët dhe institucionet financiare të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe nuk janë duke u dëmtuar nga ata që dëshirojnë të përfitojnë nga trajtimet e pafavorshme ndaj konsumatorëve. Së fundi, BQK po punon ngushtë me institucionet financiare për të mbështetur aftësitë e konsumatorëve që të mbrohen, duke siguruar që institucionet financiare të zhvillojnë në mënyrë efektive trajtimin e procesit të ankesave dhe monitorimin e burimit kryesor të këtyre ankesave.

Informatat e mbledhura nga monitorimi i tregut, veprimeve mbikëqyrëse dhe analizave të ankesave do të përdoren për të përmirësuar shpalosjen e informatave për klientët dhe aftësinë për të përdorur informatat për vendimmarrje në rast të zgjedhjes së produkteve financiare. In-

stitucionet financiare të interesuara në konkurrencë të drejtë mund të bien dakord të zhvillojnë parimet e vetërregullimit që do të udhëheqin marrëdhëniet me klientët individualë dhe kompanizat rregulluese mund të fuqizohen duke pajisur Bankën Qendrore të Kosovës me mbikëqyrje efektive, në mënyrë që të detyrohet trajtimi i drejtë i konsumatorëve. Kosova po ashtu do të përfitonte nga një strategji e edukimit financiar afatgjatë, e cila do të siguronte që njerëzit t'i kuptojnë konceptet themelore financiare si nevojën për buxhetin, dobitë e kursimit dhe rregullat për huazim të përgjegjshëm.

Përsëri, mbrojtja e konsumatorit do të jetë efektive vetëm nëse konsumatorët do të mbrojnë aktivisht të drejtat e tyre. Është e rëndësishme që konsumatorët të kërkojnë aktivisht informata për të krahasuar termat dhe kushtet e produkteve financiare – dhe më e rëndësishme që të ngrenë zërin e tyre në rast se hasin në ndonjë problem. Gjithsesi, është e rëndësishme që institucionet financiare të njoftohen për problemet me të cilat ballafaqohen konsumatorët e tyre, në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje për to; dhe në rast se nuk ofrojnë zgjidhje, BQK do të marrë parasysh këtë gjatë mbikëqyrjes së këtyre institucioneve financiare.

Përfundimisht, veprimet e lartpërmendura të ndërmarra deri tani nga BQK-ja janë vetëm hapat e parë në avancimin e regjimit të mbrojtjes së konsumatorëve në një drejtim më efektiv dhe BQK do të vazhdojë të jetë e angazhuar të sigurojë që përdoruesit e shërbimeve financiare të trajtohen drejtësisht dhe të jenë të pajisur me mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Lizingu, si alternativë financiare

Në princip të gjitha asetet, pa përjashtim, mund të jenë subjekt i lizingut. Pasi që lizingu është një formë me më pak rrezik sesa huazimi, ai shpeshherë mund të jetë si formë më e lirë e financimit krahasuar me kreditë bankare.

Lizingu është një formë specifike e financimit. Si i tillë, ka domethënie të veçantë dhe po gjen gjithnjë e më shumë zbatim në sektorin publik, privat, apo edhe atë të shoqërisë civile. Edhe në Kosovë organizatat dhe institucionet nga këta tre sektorë kanë filluar të aplikojnë lizingun si metodë të preferuar të huazimit.

Me Ligjin Nr. 03/L-103, Lizingu në Kosovë definohet si një marrëdhënie financiare në të cilën lizingdhënësi hyn në një marrëveshje me shkrim me lizingmarrësin, e cila i jep lizingmarrësit të drejtën e posedimit të një aseti, që bëhet objekt i lizingut për një periudhë të caktuar të kohës, në këmbim të pagesës nga lizingmarrësi të kësteve të përcaktuara, me ose pa opsionin për blerje. Me fjalë të tjera, lizingu paraqet një formë të huazimit të aseteve (pajisjeve, sendeve, automjeteve, veglave të punës etj.), për të cilin lizingmarrësi paguan një formë qiraje, ndërsa lizingdhënësi mbetet titullar i asaj prone apo atij aseti deri në fund të kontratës, ku pastaj vendoset nëse asetet do të mbeten pronë e lizingdhënësit apo do të transferohen te lizingmarrësi.

Ka dy forma të lizingut: lizingu financiar dhe ai operativ. Te forma e parë, lizingdhënësi e transferon rrezikun e investimit te lizingmarrësi, ndërsa mban për vete rrezikun e kredisë. Te forma e dytë, lizingu operativ, kohëzgjatja e kontratës nuk është doemos fikse, lizingdhënësi si titullar i asetit ka të drejtë të aktivizojë am-

KUJTIM DOBRUNA

UDHËHEQËS

NISMA EKONOMIKE
PËR KOSOVËN
(ECIKS)



ortizimin e asetit në librat e tij afaristë dhe ka për obligim të përkujdeset për mirëmbajtjen dhe reparaturën e asetit.

Në princip të gjitha asetet, pa përjashtim, mund të jenë subjekt i lizingut. Pasi që lizingu është një formë me më pak rrezik sesa huazimi, ai shpeshherë mund të jetë si formë më e lirë e financimit krahasuar me kreditë bankare. Si një alternativë e fuqishme karshi blerjes së pajisjeve, lizingu tashmë aplikohet në Unionin Evropian në më shumë se 25% të transaksioneve të pajisjeve dhe aseteve. Lizingu pra është një formë e burimit financiar dhe vendimi "të blesh apo të marrësh me lizing" është bërë pjesë integrale e analizave moderne financiare. Njëra ndër përparësitë e lizingut është që pagesat mund të kontraktohen për afate të ndryshme kohore dhe mund t'u përshtaten nevojave konkrete të lizingmarrësit. Kjo shpeshherë mund të ndikojë pozitivisht në likuiditetin e lizingmarrësit dhe në realizueshmërinë e projektit. Me përfundimin e kontratës së lizingut, aseti i kthehet lizingdhënësit, mirëpo te kontratat afatgjata ndodh shpesh që kontrata e lizingut të vazhdohet edhe për një periudhë shtesë. Kjo nënkupton që lizingmarrësi mund të vazhdojë ta përdorë tutje asetin me një kosto edhe më të ulët.



Arsyet për lizingun

Ndër arsyet kryesore pse organizatat dhe bizneset përcaktohen për lizingun janë:

- Një ndërmarrje nuk ka fonde të mjaftueshme për të blerë asetet ose nuk ka burime alternative të financimit. Në disa raste të tjera, kompanitë preferojnë të përdorin fondet në dispozicion për qëllime që mund të jenë më profitabile. Për shembull, blerja e aeroplanëve për kompanitë e aviacionit civil është një alternativë shumë më e shtrenjtë sesa lizingu, sikurse edhe blerja e pajisjeve të prodhimit për një kompani të vogël a të mesme. Rrjedhimisht, lizingu është një burim financiar dhe një rrugë për të mundësuar përdorimin e menjëhershëm të aseteve sapo kontrata të jetë lidhur dhe kësti i parë i lizingut të jetë paguar.
- Në disa raste mund të ketë përparësi shtesë në aspektin e taksave nëse aplikohet lizingu. Për shembull, një lizingdhënës që është titullar i pronës së dhënë në lizing mund ta përfshijë amortizimin e këtij asemi në librat e vet financiarë dhe ta zbrisë amortizimin nga tatimi në fitim.
- Ka raste kur një kompani nuk është e interesuar të ketë në pronë një aset, vlera e të cilit mund të zvogëlohet shpejt si rrjedhojë e inovacionit teknologjik. Shembull tipik për këtë janë kompjuterët, të cilët shumë shpejt mund të humbin vlerën e vet, ngase në treg vazhdimisht dalin modele të reja. Kontratat e lizingut i lejojnë lizingmarrësit të ndërrojnë pajisjet ekzistuese me një kosto relativisht të ulët dhe kështu të jetë në hap me zhvillimet e fundit teknologjike.
- Në shumë vende të botës, pajisjet e kontraktuara nën lizingun operacional nuk kapitalizohen, pra nuk figurojnë në librat e lizingmarrësit. Si rrjedhojë, lizingmarrësi mund të

dëshmojë një kthim më të lartë të kapitalit të aplikuar (Return on Capital Employed - ROCE) dhe një normë më të lartë të përdorimit të asetit (Asset Utilisation Ratio - AUR).

Produktet e lizingut për herë të parë kanë filluar të ofrohen te ne nga Banka Raiffeisen në vitin 2009, nëpërmes kompanisë Raiffesein Leasing. Lizingu i ofruar nga ky institucion dhe nga disa institucione të tjera, të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës, është i natyrës financiare dhe ofrohet kryesisht për makina, pajisje, makineri dhe patundshmëri.

Si i tillë lizingu është një burim i rëndësishëm i qasjes në financa edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Kosovës, të cilat janë boshti kurrizor i ekonomisë së Kosovës. Kjo vlen aq më shumë kur merret parasysh fakti se, sipas të dhënave të Bankës Botërore (2009), vetëm çerëku i NVM-ve ekzistuese në Kosovë kanë qasje në financat bankare. Pamundësia e kësaj pjese të rëndësishme të ekonomisë që të tërheqë kapital të mjaftueshëm nga tregu tradicional i kredive bankare e vështirëson procesin e konsolidimit ekonomik të vendit, zvogëlimin e papunësisë dhe të shkallës së varfërisë. Ngërçi financiar që ka kapluar botën si rrjedhojë e krizës ekonomike dhe financiare dhe rimëkëmbja ende e brishtë ekonomike e vështirësojnë edhe më shumë gjendjen. Prandaj, futja e lizingut si alternativë në tregun financiar të Kosovës është një zhvillim mjaft pozitiv dhe, si i tillë, duhet të aplikohet më shumë në praktikë.

(Autori është udhëheqës i Nismës Ekonomike për Kosovën (ECIKS) me seli në Vjenë - www.eciks.org)

E ardhmja e bankimit të sotëm elektronik

Shërbimet bankare janë avancuar dhe bankat në Kosovë fokusohen në të qenit inovativ dhe adoptimin e teknologjive apo pajisjeve të reja elektronike bankare. Për benefitin e klientëve tanë po zbatohet ajo më e fundit, sepse ne nuk kemi trashëguar asgjë nga teknologjitë e vjetra dhe bazat janë në proces të ndërtimit filluar nga ajo më aktuale në tregun botëror.

Bankat e specializuara dhe të fokusuara në zhvillimin e shërbimeve që kanë objektiv lehtësimin e punës për klientë nëpër banka tashmë që një kohë të gjatë i kanë ndërmarrë hapat e duhur.

Teknologjia ka lehtësuar jetën në shumicën e aspekteve, për disa me ndikim më të madh dhe për disa në pritshmëri. E gjitha varet sesa jemi në gjendje secili prej nesh të pranojmë të ndryshojmë dhe të adaptohem pikësisht me mundësitë të cilat na ofrohen dita-ditës me vrull të shpejtë.

Kosova, si shtet i ri me dominim të gjeneratës Y dhe X, të ashtuquajtur gjeneratat e teknologjisë informative, krahas shteteve të zhvilluara ka shënuar progres në të gjitha aspektet në përdorim të teknologjive të reja.

Afërsisht 60 % e territorit të Kosovës është i mbuluar me internet, që në fakt është e ngjashme me mbulueshmërinë në vendet e zhvilluara dhe penetrimi i tregut me telefoni mobile arrin shifrën prej 93 %. Kjo krijon hapësirë për bankat që të plasojnë shërbime në kanale të reja alternative që janë më efikase dhe e bëjnë më të lehtë punën me bankë për klientët.

BLERTA NAZIFI

UDHËHEQËSE
E NJËSISË SË
KARTELAVE DHE
BIZNESIT
ELEKTRONIK
PROCREDIT BANK



Shërbimet bankare janë avancuar dhe bankat në Kosovë fokusohen në të qenit inovativ dhe adoptimin e teknologjive apo pajisjeve të reja elektronike bankare. Për benefitin e klientëve tanë po zbatohet ajo më e fundit, sepse ne nuk kemi trashëguar asgjë nga teknologjitë e vjetra dhe bazat janë në proces të ndërtimit filluar nga ajo më aktuale në tregun botëror.

ProCredit Banka në Kosovë i prin epitetit e të qenit ndër bankat më novatore dhe me fokus në zhvillimin dhe adoptimin e teknologjive të reja, kjo për faktin se të parët kanë filluar me lëshimin e kartelave bankare që nga viti 2001, vendosjen e bankomateve të parë në Kosovë në vitin 2002, duke pasuar me shërbime të tjera elektronike pothuajse çdo vit deri sot. Në këtë mënyrë, duke i ndërtuar standardet mbi të cilat janë krijuar dhe janë aplikuar shërbimet elektronike në përgjithësi në tregun bankar në Kosovë.

E ardhmja do të bazohet në ofrimin e shërbimeve bankare nëpërmjet teknologjive të reja. Ajo çfarë mbetet sfiduese është që sa më shpejt tregu në Kosovë të pranojë dhe të përdorë ato me qëllim të benefitit të klientëve dhe bankave. Analiza të shumta të vendeve të përafërta me zhvillim krahas Kosovës tregojnë që më shumë fokus i ofrimit të shërbimeve do të orientohet

kah zhvillimi i kanaleve më fleksibile, siç janë bankimi elektronik dhe bankimi nëpërmjet smartphonëve.

Për më shumë, bankat në Kosovë kanë filluar ofrimin e hapësirave të cilat janë të hapura për vetë shërbim 24/7, duke i bërë kështu shumë të konvencueshme për t'u përdorur nga klientët në kohën kur atyre iu nevojiten.

Transaksionet me kartelë kanë shënuar rritje të kënaqshme, edhe pse në këtë aspekt bankat kanë ende punë për të bërë, duke këshilluar klientët që të mos bartin të holla të gatshme me vete. Infrastruktura është në vend, ka shtrirje të gjerë dhe ofron siguri të procesimit të transaksioneve me kartelë bazuar në standardet dhe mandatet e MasterCard dhe VISA International, dy skemat e pagesave më të njohura ndërkombëtarisht.

Platformat e shërbimit e-Banking tashmë ofrojnë më shumë se shërbime bazë, për t'u siguruar klientëve kryerjen e shërbimeve të ndryshme, përfshirë ato tradicionale nga shtëpia ose zyra.

Bizneseve ia bënë më të lehtë menaxhimin e financave në përgjithësi, sepse kanë informata mbi llogaritë e tyre 24/7 dhe mund të realizojnë transfere pa pasur nevojë të vijnë në bankë. Për më tepër, risitë e fundit të lansuara në këtë platformë iu mundësojnë atyre të bëjnë pagesën e faturave mujore, të bëjnë pagesën e tatimeve dhe kontributeve pensionale për punëtorët e tyre në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Gjithashtu, pagesat në emër të doganave tashmë mund të realizohen dhe të paguhen duke u konfirmuar pagesat e kryera brenda minutave te personat përgjegjës në doganë.

Bizneseve si dhe individëve tashmë iu ofrohet edhe shërbimi për deponim në bankomat, që iu kursen kohën dhe iu ofron fleksibilitet duke mos u varur nga oraret e degëve për të kryer shërbime.

ProCredit Bank që nga viti 2008 ka prezantuar pikat për vetëshërbim bankar 24/7, ku klientët mund të tërheqin të holla, të deponojnë, si dhe të qasen në e-Banking për të kryer transaksione, të gjitha këto në një hapësirë të sigurt dhe komfore. Ky koncept është në linjë me trendet botërore, të cilat tashmë i kanë praktikuar bankat më të suksesshme në botë.

Bankat në Kosovë kanë zhvilluar edhe shërbime për përdoruesit e smartphonëve si dhe aplikacione të sofistikuar për bankimin në lëvizje.

SMS shërbimet po ashtu janë zhvilluar drejt ofrimit të pranimit automatik të SMS-ve për transaksione me kartelë dhe llogari, si dhe për shërbimet e kombinuara të kompanive të telekomit në Kosovë.

Sipas një raporti të Bankës Qendrore të Kosovës, krahas shteteve fqinje, Kosova ka mbulueshmëri më se të kënaqshme me bankomate për kokë banori.

POS терминаlet për pagesa me kartela ofrojnë mundësi për të bërë blerje të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve.

Degët do të mbesin në fokus edhe për një të ardhme të largët, mirëpo funksioni i tyre do të dallojë shumë nga ai që ne e shohim tani, duke u specializuar në dhënien e këshillave financiare dhe ofrimin e shërbimeve të cilat janë më komplekse. Në ndërkohë që zhvillimi i kanaleve alternative do të ketë rol kyç në zhvillimin e më tutjeshëm të shërbimeve për klientë në sektorin bankar apo edhe në sektorët e tjerë.

Nevoja e klientëve dhe preferencat e tyre gjithnjë e më tepër do të kërkojnë integrimin e kanaleve elektronike bankare dhe, në këtë mënyrë, të vendosin për mënyrën dhe kohën ku klientët duan të përfitojnë nga shfrytëzimi i shërbimeve.

Përfundimisht ajo çka mbetet sfiduese është rritja e më tutjeshme e përdorimit të shërbimeve elektronike bankare si dhe shërbimeve të ndërlidhura në mënyrë që të largohet hezitimi nga teknologjia e re, si dhe të shihen praktikisht përfitimet nga klientët.

Në bankat më të mëdha momentalisht shërbimi i marrë në degë dominon dhe është më i preferuar nga klientët, ndërsa kanalet e tjera të distribuimit, për të cilat është cekur më lart, janë më pak të aplikueshme.

Por, ky trend duket që do të ndryshojë shpejt bazuar në gatishmërinë e tregut për të pranuar kanalet alternative për shfrytëzimin e shërbimeve bankare, por mbi të gjitha edhe investimin dhe adoptimin e teknologjive të reja nga bankat krahas trendeve botërore në këtë industri.

Mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit të karrierës në sektorin bankar

ProCredit Bank-a është e njohur gjerësisht si një punëdhënëse shumë e qëndrueshme në Kosovë, duke i ofruar stafit të saj edhe perspektivë të shkëlqyeshme të karrierës edhe shpërblime konkurruese për punën e tyre. Punonjësit tanë janë pasuria jonë më e madhe dhe ne besojmë vendosmërisht në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve afatgjata të punësimit me ta.

Mundësitë e vazhdueshme për zhvillim dhe trajnim të stafit janë jetike për çdo institucion që ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm. Përmirësimi i mundësive të tilla të personelit për zhvillimin e shkathhtësive dhe aftësive për performancë të plotë në kuadër të pozitës aktuale dhe për avancimin në karrierë brenda një institucioni, është pikë kyçe e aftësimit për punë dhe vazhdimin e të ndierit të motivuar. Programet e trajnimit për të gjitha nivelet e punonjësve duhet të përfshijnë mundësitë e edukimit të dizajnuara për të siguruar që çdo punonjës përfiton, zhvillon, mirëmban dhe përmirëson njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për performancë të kënaqshme të përgjegjësive të caktuara të punës. Shpesh performanca e të punësuarve në fillim është e lidhur ngushtë me induksion dhe trajnim të vazhdueshëm të pranuar. Në përgjithësi, institucionet ofrojnë trajnime vetëm për punëtorët e rinj dhe trajnime periodike për stafin që lëviz nga një funksion në tjetrin, ndërsa nënvlerësojnë trajnimet e rregullta rifreskuese për pjesën tjetër të stafit. Kjo është dëshmuar të mos jetë qasje e drejtë. Trajnimi i vazhdueshëm ndihmon stafin të përshtatet me kërkesat e



NORA RRACI

MENAXHERE
E LARTË

PROCREDIT BANK

ndryshme të punës dhe të përmirësohet në aftësitë për të performuar në mënyrën më të mirë dhe të kuptojë potencialin e plotë. Gjithashtu krijon një grup stafi të kualifikuar, të cilët janë të gatshëm të marrin përsipër fusha të reja të përgjegjësive kur institucioni ka nevojë për ta. Përveç kësaj, trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i punonjësve është thelbësor për të zhvilluar një atmosferë pune më efikase, të motivuar dhe pozitive. Programet e trajnimit duhet të sigurojnë që aftësitë, njohuritë dhe efikasiteti i të gjithë të punësuarve është në nivelin e duhur në çdo kohë.

ProCredit Bank-a është e njohur gjerësisht si një punëdhënëse shumë e qëndrueshme në Kosovë, duke i ofruar stafit të saj edhe perspektivë të shkëlqyeshme të karrierës edhe shpërblime konkurruese për punën e tyre. Punonjësit tanë janë pasuria jonë më e madhe dhe ne besojmë vendosmërisht në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve afatgjata të punësimit me ta. Në përputhje me këtë politikë, ne investojmë burime të konsiderueshme në trajnime, duke siguruar që ekipi ynë ka aftësitë dhe motivimin e nevojshëm për t'iu ofruar konsumatorëve shërbime të shkëlqyera.

Për më shumë se 13 vjet pune në Kosovë, qasja e ProCredit Bank-ës ndaj ofrimit të shërbi-

meve bankare cilësore për ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme, si dhe klientët privatë ka rezultuar në të qenit të njohur si një partner profesional, i qëndrueshëm dhe i besueshëm.

Në mënyrë që të zbatojmë misionin tonë dhe të realizojmë vizionin tonë për një bankë të përgjegjshme, të punësuarit tanë janë me rëndësi të madhe. Çdo anëtar i ekipit tonë përfaqëson ProCredit Bank-ën dhe luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve me cilësi si dhe reagimin e përshtatshëm për nevojat e klientëve tanë. Jo vetëm që është e nevojshme për të punësuarit tanë të kenë njohuri dhe shkathtësi në fusha të caktuara në mënyrë që të arrijnë misionin dhe qëllimet tona, por është me rëndësi që ata vënë vlerat e bankës dhe filozofinë e biznesit në praktikë çdo ditë.

Ne në ProCredit Bank besojmë fuqimisht se etika bankare mund të jetë e suksesshme vetëm nëse ne kemi punëtorë të cilët identifikohen me vlerat dhe qëllimet tona dhe ndjekin ato në mënyrë aktive. Prandaj, kemi vendosur standarde të larta për zgjedhjen dhe trajnimin e stafit.

Për t'u siguruar që kjo vazhdohet, ne kemi zhvilluar një politikë të hollësishme të burimeve njerëzore bazuar në një shumëllojshmëri të elementeve kryesore. Këto përfshijnë një proces përzgjedhjeje të përshtatur me kujdes dhe një program të gjerë të kualifikimit të personelit dhe mundësi për zhvillim profesional. Ne presim nga të punësuarit tanë të ndihen personalisht përgjegjës për të siguruar cilësinë e punës së tyre dhe të përmbushin sfidat me këmbëngulësi të nevojshme për të përfunduar me sukses punët e vështira. Në të njëjtën mënyrë, ne e njohim detyrimin nga ana jonë për t'iu mundësuar njerëzve tanë përfitimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme në mënyrë që të përmbushin pritjet tona. Kështu, duke filluar nga dita e parë e punës, ne mbështesim punonjësit tanë duke u

ofruar trajnime intensive për të nxitur zhvillimin e tyre profesional në kuadër të bankës.

Trajnimi jonë përbëhet nga programet elementare dhe të avancuara për stafin e përzgjedhur rishtas, punonjësit me përvojë dhe stafin e mesëm dhe të lartë menaxherial.

Në kulturën tonë institucionale, bashkimi me ekipin ProCredit është vetëm fillimi i një procesi të vazhdueshëm të mësuarit konstant dhe zhvillimit. Çdo punonjës i ProCredit-it ka mundësinë të zhvillohet profesionalisht dhe të ndërtojë një karrierë të suksesshme në kuadër të grupit ProCredit. Ne jemi krenarë të jemi një organizatë që kultivon stafin e saj dhe mbush pozicione menaxheriale, duke promovuar brenda kompanisë. Politika e ProCredit Bank-ës është të mbështesë zhvillimin profesional të punonjësve të saj, duke u siguruar atyre mundësi për zhvillim horizontal dhe vertikal brenda kompanisë.

Katër shtyllat e trajnimeve të ProCredit Bank-ës:

-Ne krijojmë kushtet, ku punonjësit tanë mund të shfrytëzojnë maksimalisht potencialin e tyre dhe të arrijnë rezultate të mira. Për zhvillimin e të menduarit analitik dhe logjik dhe të kuptuarit e biznesit bankar ne kemi mbajtur kurse të matematikës elementare, matematikës financiare dhe të kontabilitetit për të gjithë punonjësit. Përveç kësaj, seminarët dhe punëtoritë janë organizuar edhe në nivel të grupit, të cilat lejojnë personelin nga prejardhje të ndryshme kulturore, por që ndajnë të njëjtat vlera, të diskutojnë dhe të ndajnë përvoja.

-Duke u bazuar kryesisht në kërkesat e krijuara nga profilet e ndryshme të punës brenda bankës sonë, ne kemi zhvilluar trajnime të avancuara, të dizajnuara për të azhornuar dhe për të thelluar njohuritë e specializuara të fushës së aktivitetit të punonjësve dhe gjithashtu për të rritur aftësitë e tyre analitike dhe ndërpersonale.



-Pasi që gjuha angleze është gjuha e dytë e punës në bankën tonë dhe gjuhë mësimore në akademitë ProCredit në Evropën Lindore dhe në Gjermani, ne ofrojmë kurse në anglisht për të punësuarit tanë në bazë të niveleve të ndryshme të zotësisë.

-Akademitë e grupit në Evropën Lindore dhe në Gjermani ofrojnë programe të zhvillimit profesional për personelin e mesëm dhe të lartë të menaxhmentit të bankës, të cilat përfshijnë pjesëmarrjen në kurse për një periudhë nga një deri në tre vjet.

-Shkëmbimi i përvojës me anë të vizitave në rrejetin botëror të bankave ProCredit.

Grupi ProCredit investon në trajnimin dhe zhvillimin e stafit në mënyrë që të krijojë një atmosferë të hapur dhe efektive të punës dhe të ofrojë shërbime miqësore dhe kompetente për konsumatorët.

Programi i ProCredit për bankierë të rinj

Një tjetër nismë e iniciuar në grupin ProCredit, përfshirë ProCredit Bank-ën në Kosovë, është lansimi për Programin e bankierëve të rinj. Programi për bankierë të rinj është një mundësi për trajnim zhvillimor gjithëpërfshirës për profesionistë të kualifikuar dhe studentë të sapo-diplomuar nga universitete ose institucione të tjera të arsimit të lartë.

Programi për bankierë të rinj është pika hyrëse në ProCredit Bank.

Pjesëmarrësve u ofrohet mundësia për të mësuar në lidhje me bazat e bankave, përgjegjësitë sociale dhe edukimin financiar, si dhe një kuptim të qartë të rolit të ndërmjetësimit financiar dhe ndikimit të saj në ekonominë e një vendi.

Gjatë periudhës gjashtëmujore, pjesëmarrësit ndjekin kurse dinamike dhe interaktive të

karakterizuara nga diskutime të hapura, projekte dhe punime grupore, të shoqëruara nga ushtrimet praktike, gjatë të cilave konceptet e mësuara në klasë mund të aplikohen. Natyra e programit përfshin përvojën unike të ofruar pjesëmarrësve gjatë qëndrimit të tyre së bashku me shokët e klasës larg qytetit për periudha të caktuara kohore.

Programi i bankierëve të rinj zgjat gjashtë muaj, me një grup të ri prej 30 pjesëmarrësish, me fillim në intervale tremujore. Trajnimi është i organizuar në nivel qendror dhe zhvillohet në Qendrën tonë të Trajnimeve në Prishtinë. Disa nga modulet mbahen për një periudhë prej dy javësh jashtë Prishtinës. Kandidatët e përzgjedhur nga ProCredit Bank-a për të marrë pjesë në program marrin një pagë gjatë periudhës gjashtëmujore. Shuma e pagës mund të përshtatet për njerëzit me përvojë pune.

Për pjesëmarrësit që përfundojnë programin me sukses, ekziston një mundësi e madhe që atyre t'u ofrohet punë në ProCredit Bank në Kosovë. Megjithatë, nuk ka detyrime ligjore as për bankën, as për kandidatin për të hyrë në një marrëdhënie të tillë.

Falë gjithë kësaj qasjeje të menduar nga buri-met njerëzore, ProCredit Banka vazhdon të përmbushë me sukses rolin e saj si një bankë e besueshme, bankë e përgjegjshme. Gjithashtu, ajo qëndron me politikën e saj të promovimit të kursimeve dhe ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata me klientët e saj biznesorë, me një fokus në njerëz që vlerësojnë shërbimet cilësore, transparencën, besimin dhe sigurinë.



Stimulimi i rritjes së sektorit privat në Kosovë

Shumë studime tregojnë që qasja në financa në Kosovë është një ndër tri kufizimet më të mëdha për rritjen e investimeve private në Kosovë. Të dhënat sugjerojnë që kreditë në sektorin privat në Kosovë janë të vogla në krahasim me shtetet e tjera.

Republika e Kosovës dhe institucionet e saj po bëjnë çmos në ndërtimin e një shoqërie funksionale demokratike, në arritjen e prosperitetit në shoqëri dhe vendosjen e themeleve të një ekonomie të drejtuar nga tregu në Kosovë. Sot, madje edhe skeptikët do të pajtoheshin që Kosova është në rrugën e duhur të përmirësimit të sistemit të lirë të tregut që rrit një ekonomi të vogël dhe të hapur dhe ta bëjë Kosovën një partnere të njohur të integruar në regjion. Mirëpo, sfidat e zhvillimit janë të shumta.

Institucionet në Kosovë janë të vetëdijshme se detyra tani është të lëvizim nga qëndrueshmëria e thjeshtë te detyra e vërtetë e gjenerimit të zhvillimit ekonomik. Plani Ekonomik Zhvillimor i Kosovës 2011 – 2014, i aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 2011 dhe i mbështetur plotësisht nga komuniteti ndërkombëtar, ilustron angazhimin e institucioneve të Kosovës në arritjen e prosperitetit dhe zbatimin e reformave të nevojshme që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike. Plani nënvizon reformat kyçe të sektorëve dhe parashtron një kornizë të planifikimit të zhvillimit ekonomik në arritjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimit për popullin e Kosovës. Plani, përkundër të qenit ambicioz dhe kontigjent në faktorë të jashtëm, ofron një platformë për Kosovën në largimin prej dhe/apo menagjimin e varësisë në të hyrat financiare të jashtme dhe të pakontrollueshme, uljen e varësisë në sektorin publik si një motor i aktivitetit

BERNARD NIKAJ
ZËVENDËSMINISTËR
MINISTRIA
E TREGTISË
DHE
INDUSTRISË



ekonomik dhe stimulimin e sektorit privat dhe vazhdueshmërinë e procesit të rritjes reale dhe krijimin e vendeve të punës në mbështetjen e donatorëve dhe si rrjedhojë uljen e importeve.

Si Ministri e Tregtisë dhe e Industrisë dhe si Qeveri në përgjithësi jemi përpjekur shumë gjatë tre vjetëve të fundit në krijimin e një ambienti biznesor në Kosovë, i cili është pro rritjes së biznesit dhe në të njëjtën kohë fokusohet në aktivitete, si investimi dhe promovimi i eksportit, identifikimi dhe lehtësimi i grupeve të biznesit, fuqizimi zinxhiror i vlerës së produkteve dhe shërbimeve në treg dhe inkurajimi i prodhimit vendës si dhe zëvendësimi i importeve. Ne kemi punuar pa pushim me palë të shumta të interesuara në përmirësimin e ambientit biznesor dhe investimeve, për të mbështetur sektorin privat dhe për të rritur investimet si bazë themelore për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme të ekonomisë. Përpjekjet për të përmirësuar klimën e biznesit kanë reflektuar në një përmirësim të Raportit të Bankës Botërore në Të Bërit Biznes 2014, të lëshuar kohët e fundit. Kemi përmirësim të ndjeshëm në renditjen e përgjithshme dhe brenda treguesve specifikë. Kosova ka lëvizur në vendin e 86-të në botë dhe në dy vjetët e fundit ka lëvizur në total për 40 vende në renditje (nga vendi 126 në 86). Këtë vit Kosova është njohur si reformatori numër 5

në botë, veçanërisht në treguesit, si hapja e një biznesi dhe reformat e ndërtimit dhe regjistrimit të pronave. Me krenari këtë vit Kosova ka lënë pas Kroacinë, Shqipërinë, Serbinë dhe Bosnjën në renditjen regjionale të shteteve në raportin e Të Bërit Biznes.

Shumë studime tregojnë që qasja në financa në Kosovë është një ndër tri kufizimet më të mëdha për rritjen e investimeve private në Kosovë. Të dhënat sugjerojnë që kreditë në sektorin privat në Kosovë janë të vogla në krahasim me shtetet e tjera. Kostot dhe qasja në financa gjykohej të jenë kufizimet më të larta në investimet private dhe prodhimin në Kosovë, kryesisht për shkak të efikasitetit të ulët të ndërmjetësimit financiar dhe volumit të ulët të ndërmjetësimit. Kompanitë ekzistuese e kanë të vështirë të marrin financime për shkak se përballen me shpenzime më të larta në regjion dhe shpeshherë financojnë zgjerimin e tyre me kapital vetjak, pa asnjë huazim. Spread-i i normave të interesit është më i larti në regjion.

Problemi kryesor duket të jetë paaftësia e zbatimit të vendimeve pasi proceset e gjata gjyqësore të kenë përfunduar. Shumë pak pasuri hipotekare mund të rikthehen pas një zotimi të papaguar. Shkaku kryesor i kostos së lartë të financimit është joefikasiteti i sistemit gjyqësor në zgjidhjen dhe zbatimin e rasteve, duke përfshirë pronën dhe kontestet komerciale. Në mënyrë që të adresojmë këtë çështje, Ligji mbi Procedurën Përmbartimore është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor 2012, ligj i cili parasheh krijimin e përmbartuesve privatë (duke filluar nga 1 janari 2013), që pritet ta zvogëlojnë ngarkesën e theksuar të sistemit gjyqësor, veçanërisht në lidhje me rastet civile, ekonomike dhe financiare. Kjo do të zvogëlojë edhe rreziqet e zbatimit dhe potencialisht të shkaktojë bankat të ulin normat e larta të interesit që ata ngarkojnë aktualisht.

Përveç kësaj, në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm, përfshirë dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim, Qeveria e Kosovës së shpejti do të fillojë implementimin e Skemës për Garancion të Pjeshtëm të Riskut që do t'i mundësojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat janë blloqet e ndërtimit të çdo ekonomie, të kenë qasje më të mirë të financimit dhe të jenë në gjendje të marrin kredi me kushte më të volitshme.

Me qëllim që të stimulojmë dhe të inkurajojmë investimet në Kosovë duke siguruar investitorët me infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim

të aktiviteteve biznesore, tërheqjen e investimeve private në aktivitete prodhuese, krijimin e mundësive për punë, përsheptimin e zhvillimit regjional dhe rritjen e lidhjeve ekonomike të tregut të Kosovës me ato ndërkombëtare dhe përfundimisht ndihmën e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë, specifikisht në sektorin privat në Kosovë, kemi miratuar Ligjin mbi Zonat Ekonomike. Jemi në proces të marrjes së disa hapave të paraparë me ligj para vendosjes së zonave ekonomike. Ne kemi aprovuar planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë që parasheh krijimin e dy zonave të lira ekonomike në Kosovë; një në Cjakovë dhe një në Mitrovicë.

Të gjitha këto masa kanë qëllim të ofrojnë infrastrukurën e duhur për rritjen e prodhimit të vendit në Kosovë.

Me gjithë suksesin që kemi arritur, ka ende marrëveshje që Kosova duhet t'i vazhdojë reformat që stimulojnë sektorin privat, pra gjenerojnë prodhime dhe tatime që do të kompensojnë për çdo rënie të shoqëruar të të hyrave nga doganat, sidomos tani që kemi hyrë në negociatën për MSA-në me BE-në.

Ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë të punojmë në implementimin e reformave që stimulojnë prodhimin dhe kështu zvogëlojnë disbalancin e vazhdueshëm të tregut, të rrisim investimet e huaja direkte dhe eventualisht të zvogëlojmë shkallën e papunësisë. Detyra përfundimtare e Qeverisë është që të punojë së bashku me komunitetin biznesor për një treg të hapur, të krijojë rregulla fleksibile të punës, të rrisë efikasitetin dhe konkurrencën në mënyrë që të tërheqë investime.

Më duhet të theksoj faktin se në mënyrë që të arrijmë rezultate me reformat ekonomike, ne duhet të sigurohemi që të gjitha institucionet, përfshirë edhe Kuvendin, qeverinë, komunat, odat e bizneseve, e po ashtu edhe OJQ-të të kuptojnë rëndësinë dhe përparësitë e reformave strukturale ekonomike.

Ne jemi në shtegun e duhur, por rruga për rritje të qëndrueshme ekonomike është e gjatë!

Në kërkim të ritmit të duhur për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian

Për një integrim të sekuencuar evropian

Përfitimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian nuk varen nga shpejtësia e arritjes së anëtarësimit formal në këtë komunitet, por nga gjendja në të cilën është një vend në kohën kur i bashkohet këtij sistemi politik, ekonomik dhe ligjor.

Në diskursin publik kur flitet për faktin se Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian dhe është një vend me një ekonomi në zhvillim e sipër, ekskluzivisht përmenden anët negative të këtij konstatimi. Edhe pse aspekti negativ i kësaj gjendjeje nuk duhet të nënvlerësohet, është për t'u befusuar se pothuajse askush nga pjesëmarrësit e jetës publike në vend nuk i vënë në pah mundësitë që ofron kjo situatë në kuptim të zhvillimit të përshpejtuar ekonomik, mundësi të cilat Kosova mund t'i përdorë si vlerë konkurruese karshi vendeve që janë para Kosovës në procesin e integritimit evropian.

Qasja sipërfaqësore e politikëbërësve të Kosovës ndaj procesit të integritimit në Bashkimin Evropian vërehet në faktin se përpjekjet e tyre që nga viti 1999 drejt këtij qëllimi janë të kufizuara në pjesën më të lehtë dhe më të parëndësishme të procesit të integritimit, në kopjimin dhe përkthimin literal të ligjeve të Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht, sot në Kosovë kemi një numër të konsiderueshëm të ligjeve tejet të sofistikuara, të kopjuara nga Bashkimi Evropian, të cilat, për fatin e keq të qytetarëve dhe bizneseve të këtij vendi, jo vetëm që nuk kanë lehtësuar jetën e tyre, por prodhojnë kundërefekte që përkeqësojnë problemet në vend.

Trupi legjislativ i Bashkimit Evropian, i cili njihet më mirë si *acquis communautaire*, paraqet një trup ligjor që rregullon në mënyrë tejet të detajuar shumë fusha të jetës dhe veprimtarisë eko-



**DASTID
PALLASKA**

PARTNER
MENAXHUES

PALLASKA &
ASSOCIATES
L.L.C.

nomike. Për këtë arsye, *acquis communautaire*, për kah natyra e vet, paraqet një trup ligjor tejet ndërhyrës në ekonomi. Për më shumë, zbatimi i drejtë i këtij legjislacioni në praktikë kërkon financim të konsiderueshëm. Në fakt, rregullimi tejet i detajuar ligjor i veprimtarisë ekonomike, ashtu siç parashihet me *acquis communautaire*, funksionon vetëm atëherë kur zbatimi i ligjeve shoqërohet me financim të konsiderueshëm dhe kur këto ligje vihen në jetë nga zyrtarë kompetentë dhe të ndershëm. Kjo do të thotë se nëse një trup ligjor i sofistikuar dhe i kushtueshëm, si *acquis communautaire*, zbatohet para kohe dhe në një mjedis ku nuk ekzistojnë kapacitete minimale për zbatimin e ligjeve të tilla të sofistikuara, atëherë qytetarët dhe bizneset, si përfituesit e supozuar të këtyre ligjeve, do të përballen vetëm me kundërefektet që sjell ky legjislacion. Një qasje e tillë jopërgjegjëse e politikëbërësve ndaj integritimit në Bashkimin Evropian mbart në vete edhe rrezikun e armiqësimit të shoqërisë kosovare ndaj idesë së Bashkimit Evropian, pasi që në sytë e qytetarëve dhe bizneseve të vendit ky sistem paraqet ngarkesa tejet ndërhyrëse ligjore, të cilat në duart e zyrtarëve jokompetentë transformohen në kufizime pa dobi.

Përkundër faktit se në shoqërinë tonë ekziston një konsensus i gjerë në lidhje me integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, udhëheqësit e

vendit duket se nuk e kanë kuptuar drejt qëllimin politik të këtij bashkimi dhe se si ky sistem politik, ekonomik dhe ligjor mund të përdoret për t'i siguruar Kosovës një zhvillim të përshpejtuar ekonomik dhe mirëqenie shoqërore. Aktualisht, në diskursin publik Bashkimi Evropian paraqitet si një qëllim në vete dhe shoqëria vihet në lajthitje se me arritjen formale të anëtarësimit do të zgjidhen shumica e problemeve të vendit. Në aspektin ekonomik, një vështrim mbi historinë e zhvillimit të kompanive të mëdha në Evropë tregon se shumica e kompanive që kanë përfituar më së shumti nga Bashkimi Evropian janë krijuar dhe kanë forcuar bazën e tyre para hyrjes në një mjedis ligjor të qeverisur nga *acquis communautaire*. Me fjalë të tjera, këto kompani janë krijuar në një mjedis më pak të rregulluar ligjor dhe kanë pasur mundësi të përfitojnë nga fakti se vendet në të cilat kanë vepruar kanë pasur më pak ngarkesa dhe kufizime ligjore. Duke krijuar një përparësi konkurruese në mjedise të tilla, më pak të rregulluara ligjore, këto kompani kanë lulëzuar në Bashkimin Evropian, i cili u ka ofruar atyre zgjerim të tregjeve, qarkullim të lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit dhe siguri juridike jashtë vendit amë.

Përfitimet që një vend i nxjerr gjatë procesit të integritimit dhe nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian varen kryesisht nga mënyra se si dhe me çfarë ritmi ka aplikuar ngarkesat dhe kufizimet ligjore të diktuar nga Bashkimi Evropian dhe si janë balancuar këto ngarkesa dhe kufizime me dobitë që ofron integritimi në Bashkimin Evropian. Ritmi i duhur, në këtë rast i sekuencuar, siguron jo vetëm arritjen e qëllimit formal të anëtarësimit, por garanton se anëtarësimi do të adresojë dhe do të zgjidhë problemet e shoqërisë dhe se pas anëtarësimit një vend do të mund të përfitojë nga dobitë që ofron Bashkimi Evropian. Thënë thjesht, përfitimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian nuk varen nga shpejtësia e arritjes së anëtarësimit formal në këtë komunitet, por nga gjendja në të cilën është një vend në kohën kur i bashkohet këtij sistemi politik, ekonomik dhe ligjor.


Shtrohet pyetja si mund të duket ky integritim i sekuencuar në Bashkimin Evropian? Kosova, sikurse të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, duhet të shfrytëzojë faktin se nuk është në Bashkimin Evropian, duke i ofruar ndërmarrësve në vend një mjedis për zhvillim të përshpejtuar me sa më pak ndërhyrje, ngarkesa dhe kufizime ligjore. Për më shumë, duke identifikuar kapacitetet vendëse konkurruese në ekonomi, Kosova duhet të shqyrtojë mundësinë të nxisë një zh-

villim të përshpejtuar ekonomik, duke u ofruar ndërmarrësve të rinj një mjedis biznesor miqësor dhe stimulues. Këto veprime janë të domosdoshme për të krijuar një bazë ekonomike, e cila do t'u mundësonte ndërmarrësve vendës të përfitojnë nga dobitë që sjell Bashkimi Evropian si një treg i madh me lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit. Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të përgatisë të gjitha ligjet që kërkohen nga Bashkimi Evropian, por të sigurohet se hyrja e tyre në fuqi do të ndodhë vetëm pak para anëtarësimit formal. Kjo qasje e sekuencuar ndaj integritimit evropian do të siguronte se Kosova do të krijonte hapësirë për krijimin dhe zhvillimin e kompanive konkurruese në Bashkimin Evropian, të cilat jo vetëm se do të mund të përballonin financiarisht rregullimin ligjor që parashihet me *acquis communautaire*, por edhe do t'i gëzonin përfitimet që sjell ky trup ligjor për zgjerimin e tregjeve të tyre në Evropë. Në anën tjetër, përgjatë kësaj kohe Kosova me ndihmën e Bashkimit Evropian duhet të përgatisë zyrtarët e vet publikë për të zbatuar dhe për të jetësuar dobitë dhe përfitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në familjen evropiane dhe zbatimi i *acquis communautaire*. Për dallim prej modelit aktual, ku zyrtarët e patrajnuar mësojnë praktikën e Bashkimit Evropian në kurrizin e qytetarëve dhe bizneseve, me integritimin e sekuencuar kjo përgatitje do të bëhej në një mjedis laboratorik, ku efektet negative të gabimeve të qëllimshme dhe të paqëllimshme të zyrtarëve nuk do të prodhohin pasojë negative për qytetarët dhe bizneset.

Përfundimisht, duhet të nënvizohet se edhe nëse Kosova arrin që formalisht të hyjë në Bashkimin Evropian vetëm për shkak të pozitës së vet gjeografike, atëherë dobitë dhe përfitimet që dalin nga anëtarësimi do të ishin minimale, pasi që, të marrim vetëm një shembull, rrugët e ndërtruara nga Bashkimi Evropian do të ishin njëkahore, përkatësisht nga Evropa për në Kosovë për mallrat dhe shërbimet evropiane dhe nga Kosova për në Evropë për kapitalin njerëzor të Kosovës. Si pasojë, Kosova do të mbetej një shoqëri konsumuese që në Bashkimin Evropian do të ketë rëndësinë e një tregu të vogël periferik.

Shënim për autorin: Autori është avokat dhe partner menaxhues në firmën ligjore "Pallaska & Associates L.L.C." Pikëpamjet e preztuara në këtë artikull janë personale.

© Autori i rezervon të gjitha të drejtat autoriale, përfshirë edhe publikimin e këtij artikulli në gazeta të tjera.



Terme financiare që duhet ditur

Mbitërheqja: Është term që i referohet tërheqjes së të hollave nga një llogari bankare, edhe pse në llogarinë bankare bilanci i llogarisë është 0, pra nuk ka fonde të mjaftueshme për t'i tërhequr. Në këtë rast, banka i lejon konsumatorët që janë në nevojë për tërheqje të huazojnë një shumë të caktuar të të hollave që negociohet paraprakisht nga dy palët përkatëse (banka dhe klienti).

Debit: Është një term bankar që i referohet sasisë së parave që janë marrë nga huamarrësi. Debit, po ashtu tregon sasinë e parave që duhet të paguhet, ose sasinë e parave të cilat janë marrë nga llogaria bankare. Ndërsa një debit kartë është instrument të cilin e përdorim për të tërhequr para nga banka dhe për të bërë pagesa në dyqane. Debit kartela është e lidhur me një llogari rrjedhëse bankare, prandaj për të tërhequr të holla duhet së pari të kemi të holla të gatshme në llogarinë përkatëse.

Kredit: Është një term bankar që i referohet shumës së të hollave të cilat një person mund t'i huazojë nga banka. Ndërsa kredit kartela është pothuajse e ngjashme me debit kartelën në paraqitje, por janë krejtësisht të ndryshme në përdorimin e tyre. Kredit kartela mund të përdoret për të paguar për gjësende në internet; gjithashtu, kartela e kreditit mund të përdoret për të tërhequr para nga ATM. Megjithatë, një kartelë e kreditit i ka kufizimet e saj. Diferenca

në mes të një debit dhe kredit kartele është që debit kartela përdoret kur personi ka të holla në llogarinë e tij/saj bankare, ndërsa kartela e kreditit e ka funksionin e "kredisë afatshkurtë" me limit të caktuar që jepet nga banka dhe parashihet që borxhi të kthehet në fund të çdo muaji.

Numër personal identifikimi (Personal Identification Number), ose shkurt **(PIN):** Është një kod sekret (4-shifror), i përbërë nga valuta numerike që i jepet klientit për të kryer transaksione nëpërmjet bankomatit.

Pikë shitje (Point of Sale) ose shkurt **(POS)** është një pikë shitje ku mundësohet blerja nëpërmes kartelës së debitit apo kreditit.

Depozitë kohore: Depozita në të holla që individ apo biznese vendosin pranë një institucioni bankar ose një institucioni që pranon depozita me të drejtë që t'i tërheqë fondet pas një periudhe kohore të përcaktuar nga palët e marra vesh.

Llogari kursimi: Është term që i referohet një llogarie të kursimit që pranë bankave përfaqëson depozita në të holla nga individ apo biznese kundrejt një afati për tërheqje të atyre fondeve dhe kundrejt një norme interesi që klienti përfiton gjatë depozitimit të të hollave në llogarinë kursimore.



7 këshilla për sigurimin e kartelës suaj debit gjatë një transaksioni në bankomat

Automatet për Tërheqjen e Parave (ATM-të) janë bërë pjesë e jetës sonë. Kjo pajisje bashkëkohore ndihmon në lehtësinë me të cilën tërheqim paratë tona pa prituri në radhë të gjata në degët e bankës. Edhe pse inovative, ka masa të caktuara që klientët duhet të marrin në mënyrë që të përdorin më mirë dhe të mbrojnë kartelat e tyre debit dhe kredit prej rreziqeve të caktuara. Më poshtë janë disa këshilla për t'iu ndihmuar në mbrojtjen e debit/ kredit kartelave:

Këshilla #1: Zgjidhni një vend me tollovi dhe të ndriçueshëm, sepse shkuarja nëpër vende pa njerëz dhe potencialisht të errëta është e rrezikshme, pasi që mund të jetë një vend ku hajdutët plaçkisin njerëzit gjatë kryerjes së transaksioneve me bankomat.

Këshilla #2: Gjithmonë mbani fshehur numrin e juaj PIN me dorën tjetër ose një fletore, sepse hajdutët ndonjëherë fusin mikroaparate mbi bankomatet në mënyrë që të vjedhin Numrin Identifikues Personal (PIN) të klientëve, duke regjistruar numrin 4-shifror. Për fat të mirë, bankat komerciale kanë marrë hapa në këtë drejtim kur kanë vendosur pllaka në mënyrë që të fshehin numrat 4-shifror nga vjedhjet e mundshme.

Këshilla #3: Mos pranoni ndihmë nga askush, sepse zakonisht njerëzit e huaj paraqiten sikur përpiqen t'ju ndihmojnë të konfiguroni kartelën tuaj apo t'ju ndihmojnë të përdorni bankoma-

tin (ATM), por përkundrazi ata do t'iu vjedhin kartelën dhe të ikin. Nëse keni probleme duke përdorur kartelën tuaj gjatë kryerjes së transaksioneve me bankomat, ju lutemi konsultohuni me punëtorët e bankës brenda degës, dhe me askënd tjetër.

Këshilla #4: Nëse shkoni jashtë vendit, konsultohuni me këshilltarin e llogarisë suaj për të parë cili bankomat është më i përshtatshëm dhe ka tarifata më të ulëta, për shkak se përdorimi i ndonjë bankomati jashtë vendit mund të detyrojë bankomatit të bllokojë kartelën tuaj, duke bërë kështu pushimin apo vizitën tuaj të pakëndshme. Është fuqimisht e rekomandueshme të konsultoheni me këshilltarin tuaj bankar para se të shkoni në udhëtim jashtë vendit.

Këshilla #5: Mos lini faturën tuaj të bankomatit brenda tij, sepse ky mund të jetë një vendim i rrezikshëm potencial, ngaqë hajdutët mund të vjedhin të dhënat themelore të kartelës suaj që janë të shkruara në faturë.

Këshilla #6: Numëroni paratë tuaja shpejt dhe mos shpenzoni kohë duke numëruar paratë pranë bankomatit.

Këshilla #7: Zgjidhni një PIN që mund të mësohet lehtë përmendësh dhe mos e mbani shënim apo ta regjistroni si kontakt në telefonin tuaj mobil.



4 këshilla për mbrojtjen e llogarisë suaj gjatë kryerjes së një transaksioni e-banking

E-banking është një mjet bashkëkohor që ka lehtësuar monitorimin dhe kryerjen e një transaksioni në llogaritë tona bankare. Është një mjet i dobishëm në monitorimin e llogarisë nga komoditeti i shtëpive tona. Edhe pse inovativ, ngjashëm me bankomatët, ekzistojnë çështje specifike sigurie në lidhje me përdorimin e llogarisë tonë e-banking. Më poshtë janë disa këshilla që do t'ju ndihmojnë në mbrojtjen e llogarisë suaj e-banking:

Këshilla #1: Kurrë mos e hapni/ kontrolloni llogarinë tuaj e-banking brenda një internet kafe, sepse gjithmonë ekziston rreziku që dikush të futet në kompjuterin tuaj ose thjesht të harroni llogarinë tuaj e-banking të hapur.

Këshilla #2: Raportoni çdo aktivitet të dyshimtë që mund të shihni në llogarinë tuaj.

Këshilla #3: Mos i shpalosni detajet e llogarisë suaj ose të përgjigjeni në ndonjë faqe interneti apo postë elektronike që shfaqet si ofertë speciale, sepse zakonisht këto faqe interneti/ posta elektronike paraqiten sikur të kishit fituar ndonjë lotari apo shpërblim të veçantë vetëm për të marrë informatat e llogarisë suaj.

Këshilla #4: Përdorni një fjalëkalim që është vështirë të zbulohet apo të hamendet nga dikush.

Komitetet aktive në Shoqatën e Bankave

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës funksionojnë dhjetë komitete/grupe punuese, të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Komitetet përbëhen nga ekspertë të fushës bankare të tetë bankave komerciale, anëtare të shoqatës. Profili i ekspertëve bankarë u përshtatet aktiviteteve të këtyre grupeve punuese. Këto komitete kanë rol këshillues për shoqatën dhe menaxhmentin e bankave, për çështje që ndikojnë në funksionimin më të mirë të sektorit.

Komitetet organizojnë takime të shumta, varësisht nga tema që trajtohet, me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me gjykatat, Këshillin Gjyqësor, Institutin Gjyqësor, Agjencinë Kadastrale, Administratën Tatimore, ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë këtu agjencitë të cilat funksionojnë në kuadër të këtyre ministrive dhe me të gjitha organizatat e tjera që për bazë të aktiviteteve të tyre kanë sektorin financiar në Kosovë.

Komitetet kanë bashkëpunim edhe me institucione të tjera ndërkombëtare, siç është VISA dhe

forume të tjera të ngjashme në vendet e rajonit, qëllimi i të cilave është shkëmbimi i informatave, përvojave dhe diskutimeve për zhvillimin e mëtutjeshëm të ekspertizës bankare. Komitetet organizojnë takime të rregullta me përfaqësuesit e VISA-së dhe marrin pjesë rregullisht në aktivitete të ndryshme, siç janë punëtoritë dhe konferencat rajonale.

Dhjetë komitetet funksionale në Shoqatën e Bankave të Kosovës janë:

1. Komiteti i Thesarit;
2. Komiteti i AML-së;
3. Komiteti Ligjor;
4. Komiteti i Pagesave;
5. Forumi Kundër Mashtrimeve me Kartela;
6. Komiteti i Sigurisë;
7. Komiteti i Financave;
8. Komiteti i Marketingut;
9. Komiteti i Burimeve Njerëzore;
10. Komiteti i Riskut.





Robert Wright rizgjedhet Kryetar i Bordit të Drejtorëve

Në muajin korrik, gjatë takimit vjetor të Asamblesë së Përgjithshme, është rikonfirmuar Robert Wright, kryeshef ekzekutiv në Bankën Raiffeisen në Kosovë, si kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së. Z. Wright do të shërbejë në pozitën e kryetarit të Bordit të Drejtorëve të SHBK-së edhe për një mandat dyvjeçar. Me rastin e rizgjedhjes në pozitën e kryetarit të Bordit, z. Wright u shpreh: "Është nder dhe privilegj të jem pjesë e një ekipi të shkëlqyer. Jam i sigurt se bashkërisht

do të vazhdojmë punën tonë për promovimin e aktiviteteve të sektorit bankar dhe do të bashkëpunojmë ngushtë me institucionet relevante të Kosovës për adresimin e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me këtë sektor". Për më tepër, në këtë mbledhje, z. Ilir I. Aliu, kryeshef ekzekutiv në ProCredit Bank në Kosovë, u propozua dhe u rizgjodh nga Asambleja e Përgjithshme si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së.

Përfaqësues të shoqatës së bankave të Kosovës vizitojnë shoqatën shqiptare të bankave

Gjatë muajit gusht, përfaqësues të Shoqatës së Bankave të Kosovës vizituan Shoqatën Shqiptare të Bankave, ku u mirëpritën nga Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës së Bankave Shqiptare, znj. Endrita Xhaferaj. Pikat kryesore të takimit ishin mundësitë e bashkëpunimit mes dy institucioneve për zhvillimin e sektorit bankar në të dy shtetet, si dhe shkëmbimi i eksperiencave

të institucioneve në organizimin e trajnimeve për zhvillim të kuadrove. Z. Petrit Balija, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, shtoi se "ky ishte takimi i parë zyrtar në mes të Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe është një nismë e mirë për një bashkëpunim më të ngushtë në mes të dy institucioneve".

Panairi Financiar 2013

Më 25 shtator 2013 është mbajtur Panairi Financiar 2013, i cili u mbajt në Swiss Diamond Hotel në Prishtinë, deri më 26 shtator 2013. Përveç ekspozimit të produkteve të kompanive pjesëmarrëse që ishin: bankat, institucionet e sigurimeve, kompanitë ndërtimore, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e njohura të auditimit dhe kontabilitetit, kompanitë e dizajnit dhe shtypit, në kuadër të Panairit Financiar 2013 janë mbajtur dy konferenca dhe një forum. Konferenca më e rëndësishme gjatë dy ditëve të

Panairit Financiar ishte: "Politikat e nevojshme për të reduktuar riskun në sektorin financiar", ku në panel ishin: z. Amer Ali nga kompania globale e auditimit Grant Thornton, z. Ibrahim Rexhepi, kryeredaktor në revistën "Ekonomia", z. Bernard Nikaj, zëvendësministër i Tregtisë dhe i Industrisë, z. Robert Wright, kryesues i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së dhe z. Nazif Tërshnjaku, udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK. Ndërsa në pjesën e dytë të Panairit Financiar është mbajtur konferenca më

temën: "Horizonti i ri – zgjedhja e një modeli për financimin e zhvillimit në Kosovë" dhe forumi më temën: "Sfidat aktuale dhe mundësitë e ardhshme në industrinë e sigurimeve".

Për më tepër, një ndër aktivitetet e Panairit Financiar 2013 ishte edhe punëtorja me studentë

të universiteteve publike dhe private, ku studentët patën rastin të mësojnë aspekte praktike të klientëve dhe produkteve bankare dhe, në fund i janë nënshtruar një testi të shkurtër, ku studentët më të dalluar u shpërblyen me punë praktike në bankat komerciale nëpër Kosovë.



Punëtorja me studentë, e organizuar në kuadër të Panairit Financiar 2013

Gjatë Panairit Financiar, organizuar më 25 dhe 26 shtator, SHBK ka organizuar një punëtori për studentët e Fakulteteve Ekonomike të Kosovës. Temat, të cilat studentët i kanë përcjellë gjatë atyre dy ditëve, ishin:

1. Aspektet e produkteve dhe shërbimeve për klientët e bankave, dhe
2. Aspektet relevante dhe pritjet reciproke që kanë bankat dhe praktikantët gjatë punës praktike. Studentët u shprehën të kënaqur me përmbajtjen e ligjëratave dhe shtuan se temat ishin goxha interesante dhe shumë lehtë për t'u kuptuar. Në fund të ligjëratave, studentët pjesëmarrës iu nënshtruan testit, ku ata të cilët kaluan testin filluan punën praktike në bankat komerciale të Kosovës.

SHBK shpërblyen fituesit e lojës shpërblyese nga gazeta 'Kosova Sot'

Gjatë muajve tetor dhe nëntor, në ambientet e saj, Shoqata e Bankave të Kosovës ka shpërblyer fituesit e lojës shpërblyese "Trajnim për Banka", e organizuar nga gazeta 'Kosova Sot', në kuadër të lojës shpërblyese "Festo dhe Fito", ku SHBK është po ashtu sponzor i lojës. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, z. Petrit Balija, theksoi se Shoqata e Bankave të Kosovës ndër vite është angazhuar për ngritjen e kapaciteteve të sektorit financiar dhe për të ofruar mundësi që të rinjtë të kenë qasje në programe edukative, të cilat iu mundësojnë atyre të kyçen në tregun e punës.



Kryetari i Bordit të ShBK-së merr pjesë në konferencën e Fleming Europe

Në Konferencën e organizuar nga Fleming Europe, në lidhje me Retail Banking, e cila është mbajtur më 9 dhe 10 tetor 2013, në Budapest të Hungarisë, ka marrë pjesë kryetari i Bordit të Drejtorëve të ShBK-së, z. Robert Wright, ku njëherësh ishte edhe panelist ditën e dytë të konferencës në diskutimin e parë: "Zbulimi strategjik i Retail Banking". Kjo konferencë është organizuar me qëllim që të diskutohet Retail Banking në Evropën Qendrore dhe më gjerë, si dhe të propozohen strategji se si të zhvillohet

më tej fusha e Retail Banking. Në panelin e parë të ditës së dytë të konferencës, "Zbulimi strategjik i Retail Banking", ku edhe z. Wright ishte panelist, u diskutua situata aktuale në sferën e Retail Banking, si dhe sfidat dhe mundësitë për të ardhmen e Retail Banking. Panelistët e tjerë ishin: z. Mateusz Morawlecki nga Bank Zachodni WBK, Poloni; znj. Agnes Baba nga KEH Bank, Hungari; zt. Josef Benes, nga Raiffeisen Bank në Republikën Çeke; dhe z. Igor Barat nga Pestova Bank, Sllovaki.



SHBK merr pjesë në takimin rajonal për Evropë dhe Azi Qendrore, i organizuar nga Child and Youth Finance International

Gjatë fillimit të muajit nëntor, Shoqata e Bankave të Kosovës, e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv, z. Petrit Balija, ka marrë pjesë në takimin e dytë rajonal për Evropë dhe Azi Qendrore, të organizuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) në bashkëpunim me 'Child & Youth Finance International', i cili mbahet këtë vit në Frankfurt të Gjermanisë. Temë kryesore e këtij takimi ishte edukimi financiar i qytetarëve, me fokus të veçantë në edukimin financiar të fëmijëve dhe rinisë në Evropë dhe Azinë Qendrore. Përpos rritjes së vetëdijesimit të qytetarëve dhe fëmijëve rreth fushës së financave, qëllimet e takimit po ashtu ishin që të theksohet rëndësia e lidershit të fortë në nivel rajonal, të definohet strategjia për përfshirjen e fëmijëve dhe rinisë në

fushën e financave dhe t'iu mundësojë fëmijëve dhe të rinjve të ndajnë rekomandimet e tyre me vendimmarrësit kryesorë në fushën e financave.



Trajnimet e organizuara në SHBK

“Analiza financiare”

Në kuadër të programit të trajnimeve për vitin 2013, gjatë muajit prill është mbajtur trajnimi “Analiza financiare”, ku ligjërues ishte konsulenti amerikan, William Donovan. Trajnimi ishte dizajnuar që t’u ndihmojë pjesëmarrësve të ushtrojnë njohuritë e fituara dhe kështu t’i mësojnë analizat, duke i bërë ato njëkohësisht. Me një pjesëmarrje më të madhe se zakonisht, zyrtarët e bankave patën rastin të freskojnë njohuritë e tyre me elemente të reja të vlerësimit të bizneseve, duke analizuar të dhënat financiare dhe informatat indirekte që mund të nxirren nga pasqyrat financiare.

“Parandalimi i shpëlarjes së parave”

Gjatë muajit maj është mbajtur trajnimi “Parandalimi i shpëlarjes së parave”. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të bankave komerciale në Kosovë si dhe përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës nga departamentet kundër Shpëlarjes së Parave dhe Pajtueshmërisë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte t’u mundësojë pjesëmarrësve të kuptojnë gjendjen aktuale të shpëlarjes së parasë, financimit të terrorizmit dhe krimin financiar, masat për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe konceptimin dhe zbatimin prej një qasje të bazuar në risk. Seminari u përqendrua në zhvillimet e fundit, përfshirë rekomandimet e FATF-së dhe modelin e Luksemburgut për funksionin e përputhshmërisë në institucionet financiare.

Prezantimet para studentëve të Fakultetit Ekonomik

Në kuadër të iniciativës për informim të publikut rreth sektorit bankar, Shoqata e Bankave të Kosovës ka organizuar gjatë muajit prill prezantime/seminare para studentëve të Fakultetit Ekonomik të univesitetit publik “Hasan Prishtina”. Gjithsej ishin 4 prezantime/seminare që

janë organizuar nga SHBK-ja për studentët e këtij fakulteti. Studentët u treguan shumë të interesuar dhe kureshtarë për aspektet e ndryshme që janë ligjërues në këto prezantime dhe shumica e tyre ishin aktivë, duke krijuar kështu edhe debate të ndërsjella. Temat të cilat janë prezantuar para studentëve ishin: Menaxhimi i Thesarit, nga Shpresim Vranovci, kryetar i Komitetit të Thesarit në SHBK; Parandalimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, nga Ali Krasniqi, Banka Kombëtare Tregtare; Siguria e shërbimeve elektronike, e ligjërues nga Afrim Gërguri, ProCredit Bank dhe Rëndësia e zhvillimit të stafit, ligjërues nga Genc Loxha, Raiffeisen Bank.

“Shërbimi i klientëve me qasje nga inteligjenca emocionale”

Gjatë muajit qershor u mbajt trajnimi “Shërbimi i klientëve me qasje nga inteligjenca emocionale”, ku morën pjesë zyrtarë të ndryshëm nga bankat komerciale të Kosovës. Qëllimi i trajnimit ishte që, krahas koncepteve dhe praktikave të zakonshme, t’i njoftojë kandidatët edhe me aspektet emocionale të shërbimit të klientëve, analiza e situatave konfliktuoze dhe vetëdijësi për emocionet tona dhe të klientëve kur komunikojnë.

Certifikimi EFCB Gjenerata IV

Në fund të muajit tetor ka filluar trajnimi EFCB (European Foundation Certificate in Banking), ku kishte një pjesëmarrje më të madhe se zakonisht. Ky trajnim është i dizajnuar kryesisht për studentë të vitit të 3-të të Fakultetit Ekonomik, e që kanë aspirata për të hyrë në sektorin bankar. Për më tepër, trajnimin po ashtu po e vijojnë pjesëtarë të bankave komerciale, anëtarë të SHBK-së, që janë në fillim të karrierës së tyre. Pjesëmarrësit në fund të trajnimit do të certifikohen nga EBTN. Trajnimi ka tri module



që diskutohen gjatë dy muajve sa zgjat dhe ato janë: Moduli A – Ambienti ekonomik dhe monetar; Moduli B – Marrëdhëniet klient-produkt; dhe Moduli C – Aspektet njerëzore.

“E-Banking”

Gjatë muajit tetor në Qendrën për Trajnime Bankare është mbajtur trajnimi “E-Banking”. Trajnimi njoftoi pjesëmarrësit për trendet e zhvillimit të E-banking-ut si dhe u analizuan ambientet dhe kanalet e ndryshme të distribuimit dhe funksionimit të tyre, përkatësisht mjetet që përdoren për shfrytëzimin e E-banking-ut, siç janë: interneti, telefoni mobil, etj. Për më tepër, pjesëmarrësit analizuan edhe fuqitë e dobësitë e

një uebfaqeje, ku edhe u diskutua për zhvillimin sa më kreativ të një uebfaqeje.

“PCI DSS dhe Siguria në ATM”

Gjatë muajit tetor është mbajtur trajnimi PCI DSS (Payment Card Industry Data Security Standard). Ky trajnim iu mundësoi të pranishmëve t'i mësojnë trendet dhe metodologjitë më të njohura për procesimin dhe transmetimin e informatave të kredit kartelave. Në fund të trajnimit pjesëmarrësit iu nënshtruan një testi të shkurtër, ku pas kalimit të suksesshëm të tij, pjesëmarrësit u pajisën me një certifikatë nga kompania e licensuar QSA NetHost Legislation (UK) Ltd.



Shitja Online e produkteve dhe e shërbimeve të bizneseve kosovare

Me shërbimin e-Commerce, ProCredit Bank bëhet institucioni i parë në Kosovë që u ofron bizneseve dhe tregtarëve kosovarë mundësinë e shitjes së produkteve dhe shërbimeve të tyre nëpërmjet internetit. Nëpërmes këtij shërbimi bizneset mund të pranojnë pagesa nga të gjitha kartelat VISA. Shërbimi e-Commerce krijon një mundësi krejtësisht të re të shitjes dhe u mundëson bizneseve të Kosovës të plasojnë produktet dhe shërbimet e tyre te një klientelë më e madhe në vend dhe në rajon. Me përkrahjen e platformës së sigurisë 3-D Secure (Verified by VISA), ProCredit Bank krijon një ambient të sigurt për t'i nisur hapat e parë të kësaj veprimtarie në tregun kosovar.

e-Commerce: Inovacion nga ProCredit Bank



e-Commerce
Verified by VISA

Inovacion në tregun e Kosovës
Shitja ONLINE e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve kosovare mundësuar nga ProCredit Bank



ProCredit Bank

Paguaj me e-Banking

- TATIMET
- Rrymën
- Kontributet Pensionale
- Ujin
- Telefonin
- Taksat Doganore

Shpejt e lehtë në çdo kohë dhe çdo vend

© 038 555 555 | 049 555 555 | www.procreditbank-kos.com

Pagesa e tatimeve, faturave, etj. - me e-Banking nga ProCredit Bank

ProCredit Bank ka prezantuar versionin më të ri të bankimit në internet, i cili u mundëson bizneseve dhe individëve pagesat e faturave, tatimeve, etj. nga rehatia e zyrave apo shtëpive të tyre 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Më saktësisht, me versionin më të ri të këtij shërbimi elektronik bankar sot në Kosovë mund të paguhen nëpërmes e-Banking të gjitha tatimet, taksat doganore, kontributet pensionale, rryma, uji, telefoni, etj.

Projektet e përkrahura nga Banka Raiffeisen

Përkushtimi i Bankës Raiffeisen për të përkrahur projekte dhe organizime kulturore ka vazhduar edhe gjatë këtij viti. Banka Raiffeisen ka përkrahur organizimin e PriFest, ekspozitës "Gjon Mili", etj.

PriFest këtë vit organizoi edicionin e 5-të të tij nga 20 shtator, kur ishte edhe hapja e festivalit, deri më 27 shtator kur u bë ceremonia e mbylljes së festivalit. Banka Raiffeisen vazhdoi ta përkrahë festivalin, ku edhe jemi sponsor tradicional. Gjatë javës së festivalit u shfaqën filma të ndryshëm, e Hisham Zaman, regjisori i filmit "Before snowfall" (Para dëborës), është fituesi kryesor i çmimit "Hyjnesha e Artë" në edicionin e pestë të festivalit të filmit PriFest. Drejtori ekzekutiv, Robert Wright, në ceremoninë e ndarjes së çmimeve u shpreh i kënaqur me rritjen e festivalit dhe me prurjet në festival.



Bashkëpunimi dhe përkrahja në Galerinë e Arteve të Kosovës nga Banka Raiffeisen këtë vit u shënuar edhe me përkrahjen e ekspozitës ndërkombëtare "Gjon Mili". "Gjon Mili" është ekspozitë e kuruar nga pjesëmarrës vendës dhe ndërkombëtarë. Këtë vit ekspozita shënoi edicionin e 13-të të saj dhe ishte e hapur nga 13 shtatori deri më 13 tetor 2013. Këtë edicion ekspozita është kuruar nga kritiku dhe historiani i artit, Frits Gierstberg dhe u titullua "Vetëm së bashku: fotografia dhe tjetri". Genc Kadriu fitoi çmimin "Gjon Mili" në këtë edicion.



Më 21 shtator 2013 Filarmonia e Prishtinës mbajti koncert nën dirigjimin e dirigjentit të njohur nga Austria, Robert Lehrbaumer. Ky ishte edhe koncerti i parë i këtij sezoni nga Filarmonia e Prishtinës, ngjarje që u përkrah edhe nga Banka Raiffeisen.



Kredi personale deri në 10 000 euro nga BKT

Oferta më e fundit nga BKT është ajo e kredisë personale deri në 10 000 euro, me 0 % shpenzime administrative, pa hipotekë, aprovim brenda 24 orëve dhe mundësi të tërheqjes së kredisë në kesh.

Kjo mundësi iu ofrohet personave të cilët marrin pagën në BKT apo në banka të tjera si dhe të vetëpunësuarve si mjek, avokat, inxhinier apo profesionistëve të tjerë të certifikuar.

Pakoja përfshin kredi personale me kushte preferenciale, kartë krediti PRIMA pa mirëmbajtje për vitin e parë, mbitërheqje / overdraft – nëse paga kalon në BKT, si dhe e-banking – pa mirëmbajtje vjetore.

Aplikimi mund të bëhet nga të gjitha kanalet e shitjes së BKT-së: 24 njësi dhe agjenci të BKT-së në gjithë Kosovën, duke dërguar sms në numrin 500 66 me tekst "kredi", duke plotësuar aplikacionin për kredi në web: <http://www.bkt-ks.com/web-kredi.aspx>, ose duke telefonuar në 038 666 666-ALO KREDI.

Oferta vlen deri më 31 janar 2014.

BKT kontribues i shoqërisë

Për Bankën Kombëtare Tregtare përgjegjshmëria sociale ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e saj kryesore. Si rezultat i kësaj, banka në vazhdimësi ka zhvilluar projekte të lidhura me mjedisin dhe komunitetin, në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë, ndërgjegjësimin e saj për ruajtjen e ambientit si dhe të krijojë vlera për vendin duke paguar taksa, duke ofruar produkte dhe shërbime cilësore dhe nëpërmes krijimit të mundësive për punësim.

Përshkrimi i konceptit të përgjegjshmërisë sociale të BKT-së është i bazuar në parimin "Kontribuo për shoqërinë". Në këtë kuadër, BKT bën përpjekje të vazhdueshme që të prekë jetën e secilit, duke e ndryshuar pozitivisht atë nëpërmjet zgjerimit të aktivitetit të saj bamirës në fusha të ndryshme të shoqërisë.

Instrumentet më të rëndësishme të përgjegjshmërisë sociale të BKT-së janë sponsorizimet, aktivitetet dhe disa vepra bamirësie që reflektojnë vlerat e institucionit ndaj shoqërisë dhe të punësuarve.

BKT ka qenë për tre vjet sponsor gjeneral i Superligës së Basketbollit të Kosovës dhe aktualisht është sponsor i klubit basketbollistik "Sigal" Prishtina, si dhe i klubit basketbollistik "Drita" e Gjilanit.

BKT ka qenë pjesëmarrëse dhe sponsor i disa mbrëmjeve gala, fondet e grumbulluara të të cilave kanë shkuar në dobi të fëmijëve të sëmurë, sponsor i Shoqatës së të Verbërve, sponsor i arsimit të fëmijëve me rezultatet më të larta në kolegjin "Mehmet Akif", sponsor në përkrahje të nismës "Ta pastrojmë Kosovën", etj.

Rritja gjithnjë e më e madhe e BKT-së në Kosovë, e cila aktualisht operon me 24 degë, bazohet në qëllimin e saj strategjik që të bëhet banka numër një në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, duke vazhduar rritjen e pjesëmarrjes në treg, mbajtjen e pozicionit lider në shumëlojshmërinë e produkteve, teknologjive të reja, strategjive inovative dhe interesave të ofruara.

ProCredit Bank organizon ProKid Lojërat 2013



Qindra nxënës nga të gjitha rajonet e Kosovës garuan në ProKid Lojërat e sivjetshme të organizuara nga ProCredit Bank për të nëntin vit me radhë. Përveç lojërave verore pa kufij, nxënës nga shkolla të ndryshme fillore garuan në kuizin e ditorisë në kuadër të ProKid Lojërave, duke sfiduar dhe duke testuar dijen e tyre në lëndët e gjeografisë dhe të historisë. Kjo ngjarje tradicionale shoqërohet me shumë entuziazëm, pasion dhe dije, e cila mbështetet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

ProCredit Bank dorëzon numër rekord të kapakëve të plastikës



ProCredit Bank me shumë entuziazëm ka dorëzuar 1335.20 kilogramë kapakë të plastikës të mbledhur nga personeli dhe klientët. Kjo sasi e madhe e kapakëve do të dërgohet për riciklim në Turqi dhe nga shuma e përfutur do të blihen pesë karroca invalidësh. Kështu me kapakët e mbledhur në kontribojmë në lehtësimin e jetës së pesë personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në nevojë. Njëkohësisht me qindra kilogramët e mbledhur po ashtu kontribojmë për një ambient më të pastër në Kosovë.

Gara për Videon më të mirë mjedisore

Bëhu Pjesë e Garës për

VIDEON MË TË MIRË MJEDISORE



Festivali i filmit dokumentar DokuFest dhe ProCredit Bank për të dytin vit me radhë kanë ftuar qytetarët të adresojnë çështjet mjedisore, duke filmuar video me imazhe të ndotjes ose mbrojtjes së mjedisit. Kjo iniciativë ka për qëllim adresimin vizual të çështjeve mjedisore në Kosovë

dhe ndarjen e tyre me publikun e gjerë gjatë festivalit DokuFest. Video të filmuara nga qytetarët me kamerë, telefon, aparat ose webcam janë shfaqur në edicionin e sivjetshëm të DokuFestit.

ProCredit Bank, mbështetësi kryesor i DokuFest-it



Sponsor Gjeneral
17-25 Gusht
Prizren | **DOKU
FEST**
International Documentary
and Short Film Festival - Prizren

ProCredit Bank për të nëntin vit me radhë ka mbështetur Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar DokuFest, si sponsori

gjeneral i kësaj ngjarjeje të rëndësishme kulturore në vend.



5 këshilla para një interviste për punë

Rrugëtimi drejt gjetjes së një pune ndonjëherë mund të jetë i shkurtër, por ndonjëherë mund të jetë edhe i gjatë. Një nga arsytet pse disa njerëz mbeten në kërkim të një pune mund të jetë mungesa e përvojës së tyre, marrja e kohës së lirë për pushime, apo edhe mënyra e hartimit të CV-së së tij/saj. Në shumicën e rasteve sjelljet tona gjatë intervistës përcaktojnë bazën e marrjes së punës apo jo. Më poshtë janë disa këshilla për intervistë:

Këshilla #1: Pyetni rreth kompanisë – Shumica e njerëzve shkojnë në intervistë dhe u përgjigjen vetëm pyetjeve të parashtruara nga intervistuesi. Megjithatë, ata harrojnë që për t'u punësuar duhet të njohin kompaninë tërësisht. Një ndër këshillat gjatë intervistës për punë është të pyetni intervistuesin për atë që mund t'ju interesojnë, por nuk i keni gjetur në faqen e tyre të internetit. Shembuj të këtyre pyetjeve mund të jenë: kur u themelua kompania juaj, sa punëtorë ka, a është kompania juaj prezente edhe në vende të tjera, e kështu me radhë.

Këshilla #2: Flini mirë dhe rrini qetë – Stresi për të nesërmen dhe rishikimi i përgjigjeve tuaja pas mesnate - ditën para intervistës - me siguri që nuk do të ndihmojë në arritjen e qëllimit tuaj. Një ndër arsytet pse njerëzit dështojnë gjatë intervistës është stresi i tyre gjatë intervistës, me mendimin se në qoftë se nuk e marrin punën, do të jenë të destinuar që gjithmonë të mbeten pa punë. Për fat të mirë ka shumë vende të punës në treg, kështu që stresi mbi një vend të punës nuk do të rritë shanset tuaja; pra, flini mirë natën para intervistës dhe gjithmonë rrini të qetë gjatë intervistës.

Këshilla #3: Hulumtoni kompaninë – Kjo këshillë lidhet me këshillën e parë për parashtrimin e pyetjeve për kompaninë. Punëdhënësi juaj i ardhshëm do të dëshirojë një punëtor të interesuar për kompaninë – faqja e internetit e kompanisë është burimi më i dobishëm në arritjen e këtij qëllimi. Hulumtoni për kompaninë dhe kur të keni rastin, bëni pyetje në lidhje me kompaninë.

Këshilla #4: Qëndroni pozitiv gjatë intervistës – Gjatë intervistës mos komunikoni emocionet negative që mund të keni ndaj punëdhënësit tuaj të mëparshëm, punës apo detyrave, pasi që kjo mund të shkaktojë kundërefekt dhe intervistuesi mund t'ju etiketojë si një person pa integritet dhe selektiv në punën e tij/saj. Gjithmonë përcillni aspektet pozitive të asaj që keni mësuar nga puna juaj e kaluar, detyrat apo nga punëdhënësi.

Këshilla #5: Mendoni për cilësitë tuaja para intervistës – Para se të shkoni në intervistë, gjithmonë mendoni për cilësitë apo talentet që mund t'i përdorni në një intervistë. Njohja më e mirë e vetvetes e bën më të lehtë përcjelljen më të mirë të cilësive tuaja te punëdhënësi juaj i ardhshëm.



CERTIFIKIMI I PËRGJITHSHËM NDËRKOMBËTAR BANKAR

BAZAT E AFARIZMIT BANKAR | EFCB

European Foundation Certificate in Banking



**FITONI NJOHURI DHE
CERTIFIKATË BANKARE**

**KRIJONI VETES PËRPARËSI
GJATË REKRUTIMIT NË BANKA**

**PËRFITONI NGA CERTIFIKATA E
NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT**

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës:

038 246 171
kbatraining@bankassoc-kos.com
www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

THE KOSOVO BANKER
MBËSHTETET NGA
FONDI EVROPIAN PËR
EVROPËN JUGLINDORE

